



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



UNITED NATIONS  
ALBANIA



# Hartëzimi i Shërbimeve Sociale



## në Shqipëri



Leave  
No One  
Behind



**Hartëzimi i**  
Shërbimeve Sociale  
në Shqipëri

Ekspertiza dhe asistencë teknike për përgatitjen e këtij dokumenti është mbështetur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara – PNUD, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” faza e dytë (LNB2), që zbatohet në partneritet me Qeverinë Shqiptare dhe financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të PNUD në Shqipëri.

Tiranë, Maj 2023

Të dhënat e këtij raporti i përkasin periudhës Maj 2023.

**Përgatitur nga:**

Prof. Asoc. Dr. Arlinda Ymeraj, Jolanda Salati dhe Meriglana Rusta

**Ndihmuan:**

Ermelinda Jankishta, specialiste e shërbimeve shoqërore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Shërbimi Social Shtetëror Rajonal, degët Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Shkodër, Korçë, Berat, Lezhë, Dibër, Kukës, Gjirokastër dhe Vlorë.

Punonjësit e drejtorive të shërbimit social në 61 bashkitë e vendit.

Punonjësit e institucioneve të përkujdesit social në të gjitha institucionet publike dhe “Jo-Publike” të vendit.

# TABELA E PËRMBAJTJES

I. Hyrje	7
II. Shkurtesa	8
III. Përmbledhje	10
III.1 Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror dhe përfituesit e tyre	12
III.2 Kapacitetet institucionale në funksion të sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror	14
III.3 Vlerësimi i nevojës	15
IV. Lista e tabelave dhe figurave	16
V. Metodologjia	20
V.1 Metoda e studimit dhe cilësitë e saj	20
V.1.1 Instrumentat dhe modeli i kërkimit	20
V.1.2 Analiza përshkruese e të dhënave	21
V.1.3 Analiza plotësuese mbështetur në të dhëna nga burime dytësore	22
V.2 Mbledhja e të dhënave në terren	23
VI. Shërbimet e përkujdesit shoqëror: analiza e situatës	26
VII. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror	46
VIII. Burimet njerëzore, financiare dhe institucionale, në funksion të shërbimeve të përkujdesit shoqëror	62
IX. Vlerësimi i nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror	72
X. Analiza e situatës së krahasuar 2023/2021: përmirësime, sfida dhe rekomandime	84
XI. Shtojca 1: Pyetsori individual, instrumenti mbledhjes të të dhënave nga burime parësore	86
XII. Shtojca 2: Formati i tabelës së unifikuar me të dhëna statistikore sipas bashkive	92
XIII. Shtojca 3: Tabelat nga 12 deri tek 16	94



# I. HYRJE

Gjatë viteve, qeveria shqiptare ka hartuar dhe zbatuar disa strategji thelbësore dhe plane kombëtare veprimi me qëllim rritjen, fuqizimin, përmirësimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, drejt realizimit të së drejtës të qytetarëve për përfitimin e shërbimeve të cilësishme dhe sipas nevojës.

Ofrimi dhe sigurimi i shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror në nivel vendor, pjesë e reformës të mbrojtjes shoqërore, ka qenë dhe mbetet objektiv strategjik drejt përfshirjes shoqërore të të gjitha grupeve më të përjashtuara ose në rrezik përjashtimi.

Zbutja e varfërisë, përfshirja sociale, dhe mbështetja e grave, fëmijëve, familjeve dhe individëve në kushte kritike ekonomike dhe shoqërore, përbëjnë objektivat strategjike të Qeverisë, rreth të cilave është ndërtuar Strategjia e Mbrojtjes Shoqërore. Ngushtësisht e lidhur dhe në harmoni me procesin vijues të zbatimit të reformës të Mbrojtjes Shoqërore, është edhe sigurimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, një nga objektivat parësor të saj. Sigurimi i shërbimeve cilësore të kujdesit shoqëror mbështetet plotësisht nga Ligji mbi "Shërbimet e Kujdesit Shoqëror", i cili i hapi rrugën ngritjes së sistemit të ri, me bazë komunitare të shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror.

Programi i përbashkët i Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas, faza e dytë" (LNB2) synon të fuqizojë individët dhe grupet e përjashtuara që të kenë mundësi të barabarta në përdorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, kështu, duke ndihmuar pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrjen publike, për çështje që ndikojnë në jetën e tyre dhe në atë të shoqërisë shqiptare si edhe në rritjen e përgjegjshmërisë të institucioneve – siguroes të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Programi LNB 2 është një program i rëndësishëm zhvillimi për qeverinë shqiptare, në veçanti për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Shoqërore, që është edhe partneri kryesor. Ky program zbatohet nga UNDP, UNICEF, UN Women, dhe UNFPA me mbështetje financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Hartëzimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, në përputhje të plotë me objektivat e programit LNB2 sjell informacion të plotë dhe gjithëpërfshirës mbi institucionet e përkujdesit shoqëror si edhe shërbimet që ato sigurojnë, të analizuar në disa drejtime. Përtej përshkrimit, ky ushtrim, nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga burime parësore dhe dytësore të informacionit, nga specialistët e shërbimeve shoqërore në çdo bashki të vendit, ndihmon në krijimin e pasqyrës së plotë jo vetëm mbi tipologjinë dhe llojin e shërbimeve, por edhe rolin e tyre në plotësimin e nevojave shoqërore të përfituesve të shërbimeve.

Hartëzimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, i plotësuar edhe me të dhënat mbi ofruesit e shërbimeve, publike dhe "jo-publike", sjell evidenca teknike të mjaftueshme, të plota dhe shumë dimensionale, të vlefshme për mbështetjen e debatit politik mbi drejtimet e zhvillimit të sistemit në të ardhmen, me qëllim realizimin e të drejtës së qytetarëve për mbrojtje shoqërore në çdo bashki të vendit.

## II. SHKURTESA

AK	Aftësi të kufizuara
DRSHSH	Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve Shoqërore
LNB 2	Leave no one behind 2 (Askush të mos mbetet pas)
MIS	Menaxhimi i Sistemit të Informacionit për shërbimet e kujdesit shoqëror
MKR	Mekanizmi Koordinimit dhe Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NjMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NjVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UN Women	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët



# III. PËRMBLEDHJE

Raporti i studimit “Hartëzimi i Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror” mbështetur në metodologjinë e ndërtuar për qëllim të këtij studimi, duke përdorur të dhëna dhe informacione të mbledhura nga punonjësit e sektorëve të mbrojtjes dhe shërbimeve shoqërore në të gjitha bashkitë e vendit, analizon sistemin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Shqipëri në drejtim të:

- Shërbimeve të ofruara për qytetarët në nevojë dhe mundësisë të tyre për të aksesuar shërbime.
- Përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mundësisë së tyre për të plotësuar nevojën.
- Vlerësimit të kapaciteteve administrative dhe institucionale, njerëzore dhe financiare në raport me funksionimin efektiv të sistemit.
- Vlerësimit të nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror.


Studimi evidentoi se:



### III.1 SHËRBIMET E PËRKUJDESIT SHOQËROR DHE PËRFITUESIT E TYRE

- a. Shërbimet e përkujdesit shoqëror si në numër e tipologji, janë të pamjaftueshme.
- b. Shpërndarja e shërbimeve të përkujdesit shoqëror nuk është e njëtrajtshme nga pikëpamja gjeografike dhe nuk mbështetet mbi analizën e problemeve të tjera ekonomike e sociale të zonave të vendit.
- c. Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas grupeve përfituese nuk reflektojnë plotësisht nevojat e grupeve meqenëse ka grupe të mbi trajtuara, grupe të nëntrajtuara dhe grupe të patrajtuara.
- d. Shërbimet e përkujdesit shoqëror nuk përputhen ende me nevojën e përgjithshme dhe specifike të qytetarëve për shërbime.
- e. Sot në Shqipëri ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 391 institucione ose 16% më shumë sesa në vitin 2021. Këto institucione sigurojnë 1,147 shërbime të përkujdesit shoqëror ose 2,3 herë më shumë se sa në vitin 2021 për 36,642 përfitues, individë në nevojë. Ndërsa Institucionet "Jo-Publike" përbëjnë 39% të numrit të përgjithshëm, duke siguruar 46% të të gjitha shërbimeve për 62% të përfituesve, institucionet e tipit të "përzierë" përbëjnë 31% të numrit të përgjithshëm dhe sigurojnë 46% të shërbimeve për 18% të përfituesve. Institucionet publike përbëjnë 30% të numrit të përgjithshëm, dhe prej tyre përfitojnë 19% e individëve në nevojë.
- f. 15% e institucioneve janë kombëtare dhe mbulojnë të gjithë territorin, 14% janë rajonale dhe mbulojnë përkatësisht qarqet në të cilat institucionet janë ngritur dhe funksionojnë, ndërsa 71% e institucioneve janë lokale dhe sigurojnë shërbime për bashkitë përkatëse.
- g. Tirana siguron më shumë se 1/5 e shërbimeve (23%), e ndjekur nga Korça, 19% dhe Shkodra e Elbasani secila nga 11%, për të vijuar me qarqet e tjera, të cilat së bashku sigurojnë rreth 35% të shërbimeve. Por, edhe pse Qarku Tiranë siguron numrin më të madh të shërbimeve, për shkak të popullsisë gjithashtu të lartë në numër në qarkun Tiranë, numri i shërbimeve për 100 mijë banorë është sa 1/3 e numrit të shërbimeve të siguruar në Korçë dhe sa 1/2 e shërbimeve të siguruar në qarkun e Shkodrës.
- h. Shërbimet "Parashoqërore" përbëjnë 1/5 ose 21% të të gjitha shërbimeve, të pasuara nga ato "Komunitare" dhe "Qendrat Ditore" përkatësisht 14% dhe 13%. Shërbimet më pak të përhapura janë "Strehëzat" dhe "Kujdesi alternativ", përkatësisht me 3%.
- i. Rreth 1/3 e shërbimeve ose 29% janë shërbime që sigurohen për "Individë të familjeve në nevojë". Shërbimet për "Fëmijë me AK" (22%) përbëjnë grupin e dytë më të trajtuar. Këto dy shërbime përbëjnë 51% të të gjitha shërbimeve. Të gjitha shërbimet e tjera sëbashku përbëjnë 49% të shërbimeve.

- j. Në 7 qarqe ofrohet çdo tipologji e shërbimeve. Vetëm në Qarkun e Dibrës, Lezhës dhe të Fierit mungojnë dy tipologji, përkatësisht në Dibër mungojnë Shërbime Rezidenciale dhe Kujdes Alternativ, në Lezhë mungojnë "Strehëzat" dhe "Shërbimet e Këshillimit", ndërsa në Fier mungojnë Strehëza dhe Kujdes Alternativ. Në dy qarqe të tjera mungon nga një shërbim, përkatësisht në Gjirokastrë mungojnë "Strehëzat" dhe në Kukës mungojnë shërbimet për "Familjen".
- k. Në 7 bashki, përkatësisht në Libohovë, Këlcyrë, Dropull, Memaliaj, Mirditë, Fushë-Arrëz, Himarë nuk ofrohet asnjë shërbim. Në 3 bashki, përkatësisht në Patos, Mallakastër, Divjakë ofrohet vetëm nga 1 shërbim. Në 6 bashki, përkatësisht në Kuçovë, Përmet, Tepelenë, Kolonjë, Has, Selenicë, ofrohen nga 2 shërbime. Në 7 bashki, përkatësisht në Skrapar, Klos, Gramsh, Tropojë, Malësi e Madhe, Delvinë, Finiq, ofrohen nga 3 shërbime. Në 5 bashki, përkatësisht në Shijak, Belsh, Peqin, Vau i Dejës, Rogozhinë, ofrohen nga 4 shërbime. Në 4 bashki, përkatësisht në Dimal, Bulqizë, Devoll, Konispol, ofrohen nga 5 shërbime. Në 1 bashki, në bashkinë Kavajë, ofrohen 7 shërbime. Në 5 bashki, përkatësisht në Poliçan, Roskovec, Kurbin, Pukë, Vorë ofrohen nga 8 shërbime. Në 2 bashki, përkatësisht në Librazhd dhe Maliq, ofrohen nga 9 shërbime. Në 1 bashki, në bashkinë Prrrenjas ofrohen 10 shërbime. Në 1 bashki, në bashkinë Cërrik ofrohen 11 shërbime. Në 19 bashkitë e tjera, përkatësisht në bashkinë Berat, Durrës, Krujë, Dibër, Mat, Elbasan, Fier, Lushnje, Gjirokastrë, Korçë, Pogradec, Pustec, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Kamëz, Vlorë dhe Sarandë, ofrohen më shumë se 11 shërbime, dmth ofrohen të gjitha tipologjitë e shërbimeve.
- l. Në 7 bashki, përkatësisht në Libohovë, Këlcyrë, Dropull, Memaliaj, Mirditë, Fushë-Arrëz, Himarë nuk ofrohet asnjë shërbim për asnjë grup. Në 20 bashki, përkatësisht në Kuçovë, Shijak, Skrapar, Bulqizë, Klos, Belsh, Peqin, Gramsh, Patos, Mallakastër, Divjakë, Përmet, Tepelenë, Devoll, Has, Tropojë, Vorë, Rogozhinë, Delvinë, Konispol, ofrohen shërbime vetëm për një grup në nevojë. Në 14 bashki, përkatësisht në Poliçan, Dimal, Cërrik, Librazhd, Prrrenjas, Roskovec, Kolonjë, Kurbin, Malësi e Madhe, Pukë, Vau Dejës, Kavajë, Finiq, Selenicë, ofrohen shërbime për dy grupe në nevojë. Në 2 bashki, në Mat dhe Pustec ofrohen shërbime për 3 grupe në nevojë. Në 2 bashki të tjera, në bashkitë Kukës dhe Kamëz ofrohen shërbime për 4 grupe. Në 4 bashki, përkatësisht në Sarandë, Maliq, Fier, Dibër ofrohen shërbime për 5 grupe. Në 6 bashki, përkatësisht në Berat, Krujë, Lushnje, Gjirokastrë, Pogradec, Lezhë ofrohen shërbime për 6 grupe. Në bashkitë Vlorë dhe Durrës ofrohen shërbime për 7 grupe. Në Elbasan dhe Korçë ofrohen për 9 grupe, në Shkodër për 10 grupe, ndërsa në Tiranë ofrohen shërbime për të gjitha grupet.
- m. Të rinjtë në konflikt me ligjin, Viktimat e trafikut dhe të Rinjtë me probleme sociale dhe ekonomike janë grupimet më pak të trajtuara me shërbime. Vetëm 0,4% e shërbimeve parashoqërore, 0,6% e shërbimeve komunitare, 0,7% e qendrave ditore, 0,8% e shërbimeve të specializuara, 1% e shërbimeve në familje dhe 1,6% e shërbimeve të këshillimit, janë të orientuara për të ndihmuar mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të të rinjve në konflikt me ligjin, grupimi më pak i trajtuar me shërbime të përkujdesit shoqëror. 1,2% e shërbimeve komunitare, 1,3% e shërbimeve parashoqërore, 1,6% e



shërbimeve të këshillimit, 1,7% e shërbimeve të specializuara, 1,8% e shërbimeve të emergjencës dhe 2,4% e shërbimeve rezidenciale ofrohen për viktimat e trafikut.

- n. Individët me probleme ekonomike dhe sociale si edhe fëmijët me aftësi të kufizuara aksesojnë larmishmëri tipologjish të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- o. Të moshuarit, si kategoria e tretë, përfituese e 13% të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përdor 20% të shërbimeve rezidenciale, 19% të shërbimeve të emergjencës, 17% të shërbimeve të qendrave ditore si edhe po kaq të shërbimeve në familje.
- p. Numri mesatar i përfituesve për çdo institucion dhe shërbim Jo-Publik është 2 herë më i lartë se sa i treguesi i institucioneve dhe shërbimeve publike dhe të përziera.
- q. 73% e përfituesve të shërbimeve publike, i përkasin Institucioneve që financohen nga bashkitë, ndërsa 62% e përfituesve të shërbimeve Jo-Publike i takojnë institucioneve që financohen nga OJF lokale. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror janë kryesisht fëmijët deri 16 vjeç (47%), të pasuar nga grup moshë 25 deri 65 vjeç. Të moshuarit mbi 65 vjeç përbëjnë vetëm 12% të përfituesve.
- r. Në Tiranë (qarku me numrin më të lartë të përfituesve dhe shërbimeve) mesatarisht një shërbim i përkujdesit shoqëror përfitohet nga rreth 6 herë më shumë përfitues se sa në Dibër (qarku me numrin më të ulët të shërbimeve dhe përfituesve).
- s. 22% e institucioneve ose 85 institucione janë ende të palicensuara. Këto janë kryesisht institucione lokale ( nivel bashkie).

### III.2 KAPACITETET INSTITUCIONALE NË FUNKSION TË SISTEMIT TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

- a. 3,753 punonjës planifikojnë, administrojnë, sigurojnë dhe ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në të gjithë vendin, në bashki dhe institucione të përkujdesit shoqëror, qofshin publike, private ose të përziera. 78% e tyre ose 2,916 punonjës janë drejtëpërsëdrejti të angazhuar me funksionimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucione, ndërsa 22% ose 837 punonjës mbështesin funksionimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në bashkitë e vendit.
- b. 81% e stafit të institucioneve i përket gjinisë femërore, ndërsa 67% e stafit është me arsim të lartë. Gjithashtu 67% e stafit është e angazhuar në sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, 23% është staf mbështetës, ndërsa drejtuesit përbëjnë 10% të të gjithë burimeve njerëzore. 85% e stafit është i angazhuar me kontratë me kohë të plotë, ndërsa pjesa tjetër, me kontratë me kohë të pjesshme. 214 punonjës janë të angazhuar si vullnetarë, në institucionet e tre qarqeve të vendit, përkatësisht në Korçë (16 vullnetarë), Shkodër (46 vullnetarë) dhe Tiranë (152 vullnetarë).
- c. Çdo punonjësi i takon të kujdeset mesatarisht për 6 (Gjirokastra) deri 18 (Kukësi) përfitues shërbimesh.

### III.3 VLERËSIMI I NEVOJËS

- a. Individët në nevojë ekonomike dhe sociale përbëjnë grupin me peshën më të madhe, 31%, i pasuar nga "Të moshuarit"(24%), "Të rritur AK"(18%), "Fëmijë në kushte kritike" (10%), "Pa strehë"(6%), "Gra" (5%), "Fëmijë AK" (4%) dhe "Të rinj në nevojë" (1%).
- b. Qarku me numrin në të vogël të individëve në nevojë në raport me popullsinë, është Gjirokastra, ndërsa ai me përqindjen më të lartë është Tirana.
- c. Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror përfaqësojnë vetëm 3,4% të përfituesve të ndihmës monetare, gjë e cila kërkon trajtimin me përparësi të nevojës të fuqizimit të shërbimeve ekzistuese si edhe të ndërtimit të shërbimeve të reja.
- d. Vlerësimi cilësor argumenton nevojën e ndërtimit të 384 shërbimeve të tjera, nga të cilat rreth 25% duhet të shërbejnë për të moshuarit, ndërsa 18% për të rritur me aftësi të kufizuara.






# IV.

## LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

Tabela 1	Qendrat e përkujdesit shoqëror, Shërbimet, Përfituesit sipas qarqeve, numër dhe përqindje	26
Tabela 2	Shpërndarja gjeografike e qendrave të përkujdesit shoqëror, mbulimi i territorit dhe statusi i licencimit	28
Tabela 3	Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas qarqeve, financuesit, numër dhe përqindje	30
Tabela 4	Shërbimet sipas tipologjisë, llojit të qendrave të përkujdesit shoqëror dhe mënyrës së financimit	36
Tabela 5	Shërbimet sipas tipologjisë dhe qarqeve, numër.	40
Tabela 6	Përfituesit e shërbimeve sipas qarqeve, llojit të qendrave të përkujdesit shoqëror si edhe mënyrës së administrimit e financimit të shërbimeve, numër dhe përqindje	48
Tabela 7	Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas qarqeve, grupeve të përfituesve, gjinisë	50
Tabela 8	Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas grupeve të përfituesve si edhe përfituesit në numër, sipas qarqeve	54
Tabela 9	Kapacitetet administrative, burimet njerëzore që sigurojnë ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet përkatëse.	64
Tabela 10	Individët në nevojë sipas gjinisë, si edhe në % ndaj popullsisë	74
Tabela 11	Vlerësimi cilësor i nevojës për shërbime të munguara, sipas grupeve, bashkive dhe qarqeve	78
Tabela 12	Shërbimet sipas grupeve, bashkive dhe qarqeve (Shtojca 3)	94
Tabela 13	Popullsia e Shqipërisë sipas grup moshave dhe gjinisë (Shtojca 3)	98
Tabela 14	Përfituesit e përkujdesit shoqëror (monetare dhe shërbime) gjithsej dhe për 1,000 banorë, sipas bashkive (Shtojca 3)	104
Tabela 15	Përfitues të përkujdesit shoqëror mesatarisht për 1 punonjës, sipas bashkive (Shtojca 3)	106
Tabela 16	Numri i individëve të grupeve në kushtet më kritike të përjashtimit, sipas bashkive (Shtojca 3)	108
Figura 1	Mbulimi i territorit me shërbime nga institucionet e përkujdesit shoqëror	29
Figura 2	Institucionet, shërbimet, përfituesit sipas mënyrës së financimit dhe administrimit	32

Figura 3	Shërbimet sociale sipas qarqeve 2021/2023	32
Figura 4	Shpërndarja e shërbimeve sociale sipas qarqeve, %	33
Figura 5	Shpërndarja e shërbimeve sociale për 100 mijë banorë	33
Figura 6	Shpërndarja e shërbimeve sociale sipas tipologjisë	34
Figura 7	Shpërndarja e shërbimeve sociale sipas grupeve	35
Figura 8	Shpërndarja e shërbimeve sociale sipas tipologjisë dhe mënyrës së financimit	37
Figura 9	Shpërndarja e shërbimeve publike sipas tipologjisë dhe mënyrës së financimit	38
Figura 10	Shpërndarja e shërbimeve jopublike sipas tipologjisë dhe mënyrës së financimit	38
Figura 11	Bashki që ofrojnë deri në 11 shërbime	41
Figura 12	Bashki që ofrojnë 11 deri në 44 shërbime	42
Figura 13	Bashki që ofrojnë mbi 44 shërbime	42
Figura 14	Të dhënat e integruara të shërbimeve sipas tipologjisë dhe grupeve përfituese	44
Figura 15	Përfituesit e shërbimeve sipas llojit të institucioneve	46
Figura 16	Numri mesatar i përfituesve për shërbim dhe institucion, sipas financuesit të shërbimeve	47
Figura 17	Përfituesit sipas grup moshës, %	49
Figura 18	Përfituesit sipas grupeve dhe gjinisë, %	51
Figura 19	Përfituesit sipas qarqeve dhe gjinisë, %	52
Figura 20	Grupet e përfituesve dhe shërbimet që përfitojnë në përqindje	54
Figura 21	Renditja e qarqeve sipas numrit të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror	56
Figura 22	Renditja e qarqeve sipas treguesit të përfituesve për 100 mijë banorë	57
Figura 23	Përfitues/Shërbime për 100 mijë banorë	57
Figura 24	Përfitues për 1 mijë banorë të ndihmës monetare dhe shërbimeve	58
Figura 25	Treguesi Përfitues-Ndihmë Monetare/Përfitues-Shërbime, Raport	59
Figura 26	Burimet njerëzore të përgjithshme të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, sipas arsimit, %	65
Figura 27	Treguesi Përfitues/Staf, Institucionet e Kujdesit Shoqëror, numër	66
Figura 28	Treguesi Përfitues/Staf në Bashki, sipas qarqeve, numër	66
Figura 29	Numri mesatar i trainimeve të realizuara në secilën bashki në një vit	68
Figura 30	Përqindja e administratës së shërbimeve sociale në bashkitë e vendit, që ka marrë pjesë në trainime	68
Figura 31	Individë në nevojë për shërbime ndaj popullsisë, sipas qarqeve, %	73
Figura 32	Grupe në nevojë kritike për shërbime, përqindje	76
Figura 33	Individët në nevojë në çdo qark në % ndaj totalit	76
Figura 34	Shpërndarja e shërbimeve të munguara sipas grupeve, në përqindje	77





LEAVE  
NO ONE  
BEHIND  
ASKUSH  
TË MOS  
MBETET PAS



# V. METODOLOGJIA

## V.1 METODA E STUDIMIT DHE CILËSITË E SAJ

“Hartëzimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror” sjell një pasqyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, nëpërmjet analizës së të dhënave dhe të informacionit, të mbledhur për qëllim të këtij studimi, në katër drejtime themelore, përkatësisht:

- Analiza e situatës së Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Institucioneve që i sigurojnë ato
- Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror
- Burimet njerëzore, financiare dhe institucionale në funksion të sigurimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror
- Vlerësimi i nevojës për shërbime të kujdesit shoqëror

Ndonëse Hartëzimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror është një studim i përsëritur, përkatësisht në 2018 dhe 2021, në studimin e tanishëm janë përfshirë disa elementë të rinj, të patrajtuar më parë, përkatësisht:

- Harmonizimi i analizës të shërbimeve me analizën e kapaciteteve ofruese të shërbimeve, jo vetëm të kapaciteteve të institucioneve por edhe të bashkive, të cilat nëpërmjet strukturave të tyre udhëheqin, organizojnë, drejtojnë dhe monitorojnë shërbimet e kujdesit shoqëror.
- Vlerësimi i nevojës për Shërbime të Kujdesit Shoqëror, jo vetëm nëpërmjet analizës të të dhënave mbi përfituesit e programeve të mbrojtjes sociale, si të atyre monetare edhe të atyre të shërbimeve, por edhe nëpërmjet analizës të nevojës të paplotësuar me shërbime të kujdesit shoqëror.
- Analiza e krahasuar e shërbimeve 2023/2021 me qëllim identifikimin e arritjeve, problemeve dhe sfidave.

### V.1.1 Instrumentat dhe modeli i kërkimit

Në këtë studim është përdorur metoda përshkruese dhe analitike e studimit, e ndërtuar si një kombinim i (a) të dhënave sasiore dhe cilësore, nga burime parësore, nëpërmjet intervistave ballë për ballë me punonjësit e shërbimeve shoqërore në çdo bashki të vendit, dhe (b) të dhënave sasiore, nga burime dytësore, të prodhuara nga statistikat zyrtare në nivel bashkie.

Pyetësi (shtojcë 1) i strukturuar me pyetje gjysëm të hapura është përdorur si instrument i mbledhjes të të dhënave parësore, ndërsa “tabela format Excel” (shtojcë 2) është përdorur për mbledhjen e të dhënave dytësore. Të dhënat u mbledhën në terren, nga ekipi i krijuar për qëllim të këtij studimi.

### V.1.2 Analiza përshkruese e të dhënave

Kjo analizë shërben për të prodhuar një listë të detajuar të të gjitha shërbimeve që ofrohen në Shqipëri, sipas shpërndarjes gjeografike, nivelit të qeverisjes (kombëtar, rajonal ose lokal) si edhe llojit të shërbimeve e tipologjisë së tyre, sipas përcaktimeve të ligjit 121/2016 mbi “Shërbimet e Kujdesit Social”, neni 8.

Kështu:

Shërbimet parashoqërore konsiderohen si shërbime komunitare dhe ofrohen nga strukturat e posaçme të shërbimeve shoqërore në kuptim të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror.

Shërbime rezidenciale janë shërbimet që ofrohen në qendrat rezidenciale dhe, në çdo rast, përfshijnë të paktën shërbime të kujdesit 24-orësh dhe afatgjatë për individë në nevojë.

Shërbime komunitare janë shërbime gjysmëditore ose të plotë ditore, të ofruara në qendra ditore, sipas kategorisë së përfituesve.

Shërbimet në familje janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale.

Shërbime të specializuara janë shërbimet që ofrohen në nivel kombëtar, rajonal apo bashkie nga profesionistë të specializuar në fusha të caktuara.

Shërbim këshillimi është shërbimi i siguruar nga profesionistë të fushave të përcaktuara për individë në nevojë.

Shërbimi i emergjencës 72 orë u ofrohet individëve që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur.

Shërbimi i përkujdesjes alternative siguron zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe i ofrohet fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislativitetit në fuqi.

Shërbimet gjithashtu përshkruhen edhe sipas mënyrës së financimit.

Klasifikimi i shërbimeve është bërë sipas tipologjisë së tyre, në përputhje me ligjin, përkatësisht në shërbime:

- Parashoqërore
- Rezidenciale
- Komunitare
- Të specializuara
- Këshillim
- Emergjencë
- Kujdes alternativ

Gjithashtu në përputhje me nenin 6 të ligjit mbi “Shërbimet Sociale”, përfituesit e shërbimeve sociale për çdo bashki janë analizuar sipas përbërjes dhe gjinisë, përkatësisht sipas kategorive:

- Familje në nevojë
- Fëmijë jashtë kujdesit prindëror
- Fëmijë me aftësi të Kufizuar
- Të rinj nga familje të përjashtuara
- Të rinj në konflikt me ligjin
- Të rritur me aftësi të kufizuar
- Viktima të dhunës në familje
- Viktima të trafikut.
- Të moshuar në nevojë
- Të tjerë

Në përputhje me nenin 9 të të njëjtit ligj, shërbimet sociale në bazë të mënyrës së financimit klasifikohen në:

- Shërbime Publike, përkatësisht të administruara dhe financuara nga:
  - Qeveria qendrore
  - Qarku
  - Bashkia
  - Formë e përzier
- Shërbime “Jo-Publike”, përkatësisht të administruara dhe financuara nga:
  - Organizata Ndërkombëtare
  - OJF Lokale
  - Fondacione/Financues private
  - Formë e përzier
- Shërbime të përziera

### V.1.3 Analiza plotësuese mbështetur në të dhëna nga burime dytësore

Të dhënat dhe informacioni i siguruar nga bashkitë nëpërmjet analizës përshkruese janë pasuruar me të dhëna mbi Strukturën Demografike, Popullsinë, Përfituesit e programeve të mbrojtjes shoqërore, aktive dhe pasive, aplikuesit e programeve, pavarësisht nga përfitimi i mbështetjes, si edhe analiza e rasteve të paraqitura në bashki.

## V.2 MBLEDHJA E TË DHËNAVE NË TERREN

Të dhënat e mbledhura sipas modelit të kërkimit të përshkruar më lart janë organizuar në tabela të përgatitura më parë. Të dhënat u përpunuan në tre nivele, përkatësisht në nivel bashkie, qarku dhe kombëtar.

Të dhënat janë organizuar dhe klasifikuar plotësisht në përputhje me kërkesat e studimit, siç vijojnë:

- Të dhënat mbi shërbimet: Një listë e plotë e të gjitha shërbimeve që ofrohen sot në Shqipëri, së bashku me institucionet që i ofrojnë, në 61 bashkitë e vendit, të organizuara sipas llojit të institucioneve dhe mënyrës së administrimit e financimit të tyre, tipologjisë së shërbimeve, grupeve përfituese, qarqeve të vendit, mbulesës gjeografike dhe statusit të liçensimit.
- Të dhënat mbi përfituesit e shërbimeve, të klasifikuara sipas gjinisë, grup moshës, llojit të përjashtimit, si edhe llojit të shërbimit të përfituar.
- Të dhënat mbi burimet njerëzore në funksion të sigurimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në bashki dhe në institucione, të klasifikuara sipas numrit, gjinisë, funksionit dhe nivelit arsimor.
- Të dhëna rreth strukturave institucionale, të ngritura për të udhëhequr, administruar e mbështetur ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të plotësuara me të dhënat mbi programet e kualifikimit të ofruara në çdo bashki si edhe nevojën për investime të mëtejshme në drejtim të rritjes profesionale.
- Të dhëna rreth mundësive financiare të bashkive për të ofruar shërbime të cilësishme të kujdesit social, në përputhje me nevojën.
- Të dhëna mbi nevojën e paplotësuar me shërbime të kujdesit shoqëror.
- Të dhëna mbi sfidat me të cilat përballet qeverisja vendore në përpjekje për të siguruar shërbime të cilësishme të kujdesit shoqëror.





Spect

tunity

nes



# ANALIZA E SITUATËS



Sot në Shqipëri ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror 391 institucione ose 16% më shumë se sa në vitin 2021. Këto institucione ofrojnë 1,147 shërbime të përkujdesit shoqëror ose 2,3 herë më shumë se sa në vitin 2021 për 36,642 përfitues, individë në nevojë (Tabela 1).

Tabela 1: Qendrat e përkujdesit shoqëror, shërbimet dhe përfituesit sipas qarqeve, mënyrës së administrimit dhe financimit, numër dhe përqindje

Qarqet	Institucione				Shërbime				Përfitues			
	Gjithsej	Publike	Jo Publike	Përzier	Gjithsej	Publike	Jo Publike	Përzier	Gjithsej	Publike	Jo Publike	Përzier
Berat	13	8	1	4	55	29	6	20	1,011	269	315	427
Durrës	29	8	19	2	99	28	66	5	3,181	607	1,829	745
Dibër	14	3	6	5	48	10	22	16	515	140	114	261
Elbasan	29	3	10	16	128	12	53	63	1,856	114	606	1,136
Fier	25	11	9	5	56	29	18	9	1,791	552	802	437
Gjirokastrë	11	5	4	2	33	17	12	4	483	274	55	154
Korçë	46	11	19	16	214	53	89	72	3,223	503	1,503	1,217
Kukës	6	5		1	21	18		3	280	131		149
Lezhë	11		7	4	33		19	14	825		587	238
Shkodër	49	23	22	4	130	69	55	6	6,799	1,449	4,892	458
Tiranë	140	32	54	54	256	67	185	4	14,984	2,579	12,055	350
Vlorë	18	8	2	8	74	25	7	42	1,694	480	65	1,149
<b>Shuma</b>	<b>391</b>	<b>117</b>	<b>153</b>	<b>121</b>	<b>1,147</b>	<b>357</b>	<b>532</b>	<b>258</b>	<b>36,642</b>	<b>7,098</b>	<b>22,823</b>	<b>6,721</b>
<b>Në %</b>	<b>100</b>	<b>30</b>	<b>39</b>	<b>31</b>	<b>100</b>	<b>31</b>	<b>46</b>	<b>22</b>	<b>100</b>	<b>19</b>	<b>62</b>	<b>18</b>

Siç tregon tabela 1, Institucionet “Jo-Publike” përbëjnë 39% të numrit të përgjithshëm, duke siguruar 46% të të gjitha shërbimeve për 62% të përfituesve. Institucionet e tipit të “përzierë” përbëjnë 31% të numrit të përgjithshëm dhe sigurojnë 46% të shërbimeve për 18% të përfituesve. Institucionet publike përbëjnë 30% të numrit të përgjithshëm, nga të cilët përfitojnë 19% e individëve në nevojë.

Institucionet e kujdesit shoqëror mbulojnë me shërbime të gjithë territorin e vendit. Pavarësisht vendodhjes së tyre gjeografike, institucionet ofrojnë shërbime për individë në nevojë nga e gjithë Shqipëria (institucione kombëtare), nga qarqet (rajonale) ose vetëm nga bashkitë (lokale). Institucionet kombëtare janë kryesisht publike dhe të financuara nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Institucionet rajonale janë kryesisht Jo-Publike dhe të financuara nga burime private, ndërsa institucionet lokale janë ose Publike dhe të financuara nga bashkitë dhe/ose burime të përziera, ose Jo-Publike dhe të financuara nga OJF lokale, donatorë ose burime të përziera. Tabela 2 sjell informacion të detajuar mbi shpërndarjen gjeografike të institucioneve si edhe mbulimin e territorit si edhe mbi statusin e liçensimit të institucioneve. Të dhënat dëshmojnë se 22% e institucioneve ose 85 institucione janë të palicensuara ende. Këto janë kryesisht Institucione Lokale.


Tabela 2: Shpërndarja gjeografike e qendrave të përkujdesit shoqëror, mbulimi i territorit dhe statusi i liçensimit

Qarqet	Mbulimi i territorit me shërbime nga institucionet				Statusi liçensimit	
	Gjithsej	Të gjithë vendin	Qarqet	Bashkitë	Po	Jo
Berat	13	3	3	7	12	1
Durrës	29	7	8	14	28	1
Dibër	14		4	10	11	3
Elbasan	29	6	9	14	17	12
Fier	25	2		23	12	13
Gjirokastrë	11	3	1	7	5	6
Korçë	46	4	14	28	25	21
Kukës	6			6	6	
Lezhë	11	3		8	9	2
Shkodër	49	14	4	31	29	20
Tiranë	140	15	7	118	140	
Vlorë	18	3	5	10	12	6
<b>Shuma</b>	<b>391</b>	<b>60</b>	<b>55</b>	<b>276</b>	<b>306</b>	<b>85</b>
<b>Në %</b>	<b>100</b>	<b>15</b>	<b>14</b>	<b>71</b>	<b>78</b>	<b>22</b>

Burimi: Studimi, Maj 2023

Në përputhje me të dhënat e tabelës 2 është ndërtuar edhe Figura 1, e cila paraqit mbulimin e territorit me shërbime nga institucionet e kujdesit shoqëror. Siç edhe vërehet, 15% e institucioneve janë Kombëtare dhe mbulojnë të gjithë territorin, 14% janë Rajonale dhe mbulojnë përkatësisht qarqet në të cilat institucionet janë ngritur dhe funksionojnë, ndërsa 71% e institucioneve janë Lokale dhe sigurojnë shërbime për bashkitë përkatëse.

Figura 1: Mbulimi i territorit me shërbime nga institucionet e përkujdesit shoqëror



Burimi: Studimi, Maj 2023

Tabela 3 sjell informacion të detajuar mbi kategorizimin e shërbimeve sipas llojit, mënyrës së administrimit dhe financimit të institucioneve që i sigurojnë këto shërbime. Siç konstatohet, rreth 60% e shërbimeve të institucioneve publike administrohen dhe financohen nga bashkitë, ndërsa pak më shumë se 50% e shërbimeve të institucioneve “Jo-Publike” administrohen dhe financohen nga OJF lokale. Burimet private financojnë 31% të shërbimeve “Jo-Publike”, ndërsa buxheti i shtetit, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror financon 26% të shërbimeve të institucioneve publike.



Tabela 3: Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas qarqeve, financuesit, numër dhe përqindje

Qarqet	A. Institucione publike					B. Institucione jo publike					C. Përzier
	Gjithsej	Qendrore	Qarku	Bashkia	Përzier	Gjithsej	OJF lokale	Org. Nd.	Privat	Përzier	
Berat	29	16	0	11	2	6	0	6	0	0	20
Durrës	28	8	0	16	4	66	52	8	3	3	5
Dibër	10		2	8	0	22	4	3	12	3	16
Elbasan	12	4	0	8	0	53	12	11	12	18	63
Fier	29	2	2	23	2	18	15	0	3	0	9
Gjirokastrë	17	0	0	4	13	12	0	0	12	0	4
Korçë	53	16	0	36	1	89	16	2	71	0	72
Kukës	18	0	0	4	14	0					3
Lezhë	0					19	11	0	8	0	14
Shkodër	69	15	0	54	0	55	14	23	16	2	6
Tiranë	67	31	0	32	4	185	152	5	28	0	4
Vlorë	25	0	0	16	9	7	0	5	0	2	42
<b>Shuma</b>	<b>357</b>	<b>92</b>	<b>4</b>	<b>212</b>	<b>49</b>	<b>532</b>	<b>276</b>	<b>63</b>	<b>165</b>	<b>28</b>	<b>258</b>
<b>Në %</b>	<b>100</b>	<b>26</b>	<b>1</b>	<b>59</b>	<b>14</b>	<b>100</b>	<b>52</b>	<b>12</b>	<b>31</b>	<b>5</b>	<b>100</b>


Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 2 paraqit të plotë peshën e institucioneve, shërbimeve dhe përfituesve, përkatësisht të grupuara sipas llojit të institucioneve si edhe sipas mënyrës së financimit. Siç edhe ri-konfirmohet, Institucionet Publike të financuara nga bashkitë (49%) sigurojnë pjesën më të madhe të shërbimeve (59%) për përqindjen më të lartë të përfituesve (73%), të pasuar nga institucionet "Jo-Publike" që financohen nga OJF-të lokale (52% të shërbimeve për 62% të përfituesve). Institucionet "Jo-Publike" të financuara nga burime private janë grupi i tretë i rëndësishëm nisur nga pesha në totalin e institucioneve "Jo-Publike" (31%), ndërsa sigurojnë 31% të shërbimeve "Jo-Publike" për 22% të përfituesve.

Institucionet e llojit të "Përzier", institucione të kombinuara "Publike" dhe "Jo-Publike" përfaqësojnë 31% të numrit të përgjithshëm të institucioneve, ndërsa sigurojnë 22% të shërbimeve për 18% të përfituesve.


Figura 2 ilustron edhe peshën e institucioneve të "Përzier" si në kategorinë e institucioneve publike ashtu edhe në kategorinë e institucioneve "Jo-Publike". Këto institucione janë të bashkëfinancuara ose nga burime të ndryshme "Publike" ose nga burime të ndryshme "Jo-Publike". Institucionet "Publike-të Përzier" kanë peshë më të konsiderueshme se sa ato "Jo – Publike, të Përzier", sepse ndërsa përbëjnë 30% të numrit të përgjithshëm të institucioneve, sigurojnë 14% të shërbimeve për 13% të përfituesve, përkundrajt 5% të shërbimeve dhe 3% të përfituesve, që sigurojnë institucionet e financimit të "Përzier" nga burime "Jo-Publike".

Sa i përket institucioneve publike të financuara nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror ( Publike-Qendrore), ato përbëjnë 21% të numrit të përgjithshëm të institucioneve dhe sigurojnë 26% të shërbimeve për 14% të përfituesve.






**Figura 2: Institucionet, shërbimet, përfituesit sipas mënyrës së financimit dhe administrimit, në përqindje**



Burimi: Studimi, Maj 2023

Renditja e qarqeve sipas numrit të përgjithshëm të shërbimeve tregon se Qarku i Kukësit siguron numrin më të vogël të shërbimeve, ndërsa Qarku i Tiranës është qarku me numrin më të lartë të shërbimeve (Figura 3).

**Figura 3: Shërbimet sociale sipas qarqeve 2021/2023**




Burimi: Studimi, Maj 2023

Krahasimi i renditjes së qarqeve sipas numrit të shërbimeve në vitin 2023 me vitin 2021 në figurën 3, dëshmon se Qarqet e Dibrës, Beratit, Fierit, Korçës janë përmirësuar, ndërsa qarqet e Gjirokastrës, Lezhës, Shkodrës, Elbasanit, Durrësit janë përkeqësuar në renditje.

Figura 4 paraqit shpërndarjen e shërbimeve sipas qarqeve në përqindje. Dukshëm konstatohet se Tirana siguron më shumë se 1/5 e shërbimeve (23%), e ndjekur nga Korça, 19% dhe Shkodra e Elbasani secila nga 11%, për të vijuar me qarqet e tjera, të cilat sëbashku sigurojnë rreth 35% të shërbimeve.


**Figura 4: Shpërndarja e shërbimeve sociale sipas qarqeve, %**



Burimi: Studimi, Maj 2023

Megjithatë renditja e qarqeve sipas numrit të shërbimeve mesatarisht për 100 mijë banorë është më domethënëse për të kuptuar peshën e shërbimeve përkundrejt nevojave të qytetarëve si edhe për të vlerësuar, ndonëse në mënyrë tepër sipërfaqësore, mundësinë e qytetarëve për të aksesuar shërbime. (Figura 5). Është përdorur treguesi “shërbime për 100 mijë banorë” në vend të treguesit “shërbime për banorë” sepse numri i shërbimeve është relativisht i ulët në krahasim me popullsinë, për rrjedhojë figura nuk do të pasqyronte informacion të cilësishëm nëse do të konsiderohej treguesi i shërbimeve për banorë.

**Figura 5: Shpërndarja e shërbimeve sociale për 100 mijë banorë**




Burimi: Studimi, Maj 2023

Siç vërehet lehtësisht nga të dhënat e figurës 5, edhe pse Qarku Tiranë siguron numrin më të madh të shërbimeve, për shkak të popullsisë gjithashtu të lartë në numër në qarkun Tiranë, numri i shërbimeve për 100 mijë banorë është sa 1/3 e numrit të shërbimeve të siguruar në Korçë dhe sa 1/2 e shërbimeve të siguruar në qarkun e Shkodrës.

Shërbimet e kujdesit shoqëror sipas tipologjisë dhe grupeve përfituese janë paraqitur përkatësisht në figurat 6 dhe 7. Figura 6 tregon se Shërbimet "Parashoqërore" përbëjnë 1/5 ose 21% të të gjitha shërbimeve, të pasuara nga ato "Komunitare" dhe "Qendrat Ditore" përkatësisht 14% dhe 13%. Shërbimet më pak të përhapura janë "Strehëzat" dhe "Kujdesi alternativ", përkatësisht me 3%.


**Figura 6: Shpërndarja e shërbimeve sociale sipas tipologjisë, përqindje**



Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 7 paraqit përbërjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror sipas grupeve përfituese. Siç konstatohet, rreth 1/3 e shërbimeve ose 29% janë shërbime që sigurohen për "Individë të familjeve në nevojë". Shërbimet për "Fëmijë me AK" (22%) përbëjnë grupin e dytë më të trajtuar. Këto dy shërbime përbëjnë 51% të të gjitha shërbimeve. Të gjitha shërbimet e tjera sëbashku përbëjnë 49% të shërbimeve, përkatësisht shërbime për të moshuar (13%), për fëmijë jashtë kujdesit prindëror (8%), për "Viktima të dhunës" (8%), për të "Rritur AK" (6%), për "Romë&Egjyptianë" (4%) si edhe për të "Rinj në nevojë". Grupi më pak i trajtuar është grupi "Viktimat e trafikut", për të cilat ofrohet vetëm 1,5% e shërbimeve.

**Figura 7: Shpërndarja e shërbimeve sociale sipas grupeve**



Burimi: Studimi, Maj 2023

Me interes është analiza e kryqëzuar e shërbimeve sipas tipologjisë dhe llojeve të shërbimeve (llojeve të institucioneve që ofrojnë shërbimet) si edhe analiza sipas tipologjisë dhe grupeve përfituese. Tabela 4 pasqyron të gjitha shërbimet sipas tipologjisë të kategorizuara edhe sipas llojit të institucioneve që ofrojnë shërbimet.

Tabela 4: Shërbimet sipas tipologjisë, llojit të qendrave të përkujdesit shoqëror dhe mënyrës së financimit, numër dhe përqindje


Tabela 4: Shërbimet sipas tipologjisë, llojit të qendrave të përkujdesit shoqëror dhe mënyrës së financimit

Shërbimet sipas llojit të institucioneve	Gjithsej	Parashoqërore	Rezidenciale	Strehëza	Komunitare	Qendër zhvillimi	Qendër ditore	Familje	Të specializuara	Këshillim	Situatë emergjence	Kujdes alternativ
Publike	357	80	27	7	44	24	45	26	39	10	42	13
Qendrore	92	20	19	2	5	5	8	3	12	2	11	5
Qarku	4	2	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0
Bashkia	212	44	6	5	34	14	31	21	22	6	24	5
Të përziera	49	14	2	0	5	5	6	2	5	1	6	3
Jo publike	532	113	46	19	77	25	64	46	56	29	40	17
OJF	276	66	16	11	41	17	35	21	27	23	14	5
Donatorë	63	16	2	1	14	0	5	6	9	3	5	2
Privatë	165	26	27	7	19	6	19	14	15	3	19	10
Të përziera	28	5	1	0	3	2	5	5	5	0	2	0
Të përziera	258	45	10	4	42	11	39	27	25	22	28	5
<b>Gjithsej</b>	<b>1,147</b>	<b>238</b>	<b>83</b>	<b>30</b>	<b>163</b>	<b>60</b>	<b>148</b>	<b>99</b>	<b>120</b>	<b>61</b>	<b>110</b>	<b>35</b>
<b>Në %</b>	<b>100</b>	<b>21</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>14</b>	<b>5</b>	<b>13</b>	<b>9</b>	<b>10</b>	<b>5</b>	<b>10</b>	<b>3</b>

Burimi: Studimi, Maj 2023

Të dhënat e tabelës 4 u përdorën për ndërtimin e figures 8 në vijim, e cila tregon qartë se tipologjia e shërbimeve thuajse nuk ka asnjë ndikim nga mënyra e financimit të institucioneve/shërbimeve. Por, nuk mund të konfirmohet e njëjta gjetje për raportin ndërmjet shërbimeve sipas tipologjisë dhe mënyrës së financimit të shërbimeve të të njëjtit lloj (pra Brenda grupit “Publike” ose grupit “Jo-Publike”).

Figura 8: Shpërndarja e shërbimeve sociale sipas tipologjisë dhe mënyrës së financimit




Burimi: Studimi, Maj 2023

Siç tregojnë figurat 9 dhe 10, ekziston një lidhje ndërmjet tipologjisë së shërbimeve si edhe mënyrës së financimit të tyre.

Kështu (figura 9), nga shërbimet publike, shërbimet e financuara nga qeveria qendrore (buxheti i shtetit) si edhe bashkitë, karakterizohen nga larmishmëria si edhe një shpërndarje relativisht e drejtë ndërmjet tipologjive të ndryshme. Ndërsa tek tipologjia “Rezidenciale” është fuqishëm e pranishme tek shërbimet publike të financuara nga buxheti i shtetit, tipologjia “Komunitare” dhe “në Familje” është dukshëm e pranishme tek shërbimet publike të financuara nga bashkitë. Tipologjia e shërbimeve të tjera të financuara nga burimet e qarkut ose të përziera është më e varfër.


**Figura 9: Shpërndarja e shërbimeve publike sipas tipologjisë dhe mënyrës së financimit**



Burimi: Studimi, Maj 2023

Ndërmjet Shërbimeve Jo-Publike (figura 10), shërbimet e financuara nga OJF dhe Burime Private shfaqen më të shumëllojshme sipas tipologjisë. Tek Shërbimet Jo-Publike të financuara nga OJF dominojnë Shërbimet e këshillimit, ndërsa tek Shërbimet e financuara nga Burime Private dominojnë ato Rezidenciale.

**Figura 10: Shpërndarja e shërbimeve jo-publike sipas tipologjisë dhe mënyrës së financimit**



Burimi: Studimi, Maj 2023

Analiza e shërbimeve sipas tipologjisë dhe qarqeve (Tabela 5) tregon se në përgjithësi shkalla e shpërndarjes së shërbimeve sipas tipologjisë është deri diku e njëtrajtshme. Vetëm në Qarkun e Dibrës, Lezhës dhe të Fierit mungojnë dy tipologji, përkatësisht në Dibër mungojnë Shërbime Rezidenciale dhe Kujdes Alternativ, në Lezhë mungojnë “Strehëzat” dhe “Shërbimet e Këshillimit”, ndërsa në Fier mungojnë Strehëza dhe Kujdes Alternativ. Në dy qarqe të tjera mungon nga një shërbim, përkatësisht në Gjirokastrë mungojnë “Strehëzat” dhe në Kukës mungojnë shërbimet për “Familjen”. Në 7 qarqet e tjera ofrohet çdo tipologji e shërbimeve.

Pavarësisht këtij shpjegimi, së pari analiza sipas “Qarqeve”, sidomos për qarqet tek të cilat ofrohen të gjitha tipologjitë, nuk identifikon plotësisht shërbimet e munguara, sepse shërbimet mund të sigurohen në qendrën e qarkut por të mungojnë në bashkitë e tjera të qarkut. Së dyti, pavarësisht sqarimeve, trainimeve si dhe përsëritjes së këtij ushtrimi në intervale kohore relativisht të afërta, administrata e bashkive përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror ende ka mangësi në njohjen dhe përvetësimin e përkufizimit të shërbimeve si edhe identifikimin e dallimeve ndërmjet tipologjive të ndryshme. Për rrjedhojë, analiza sipas tipologjisë është orientuese dhe vlerësuese por kurrsesi nuk mund të konsiderohet burimi thelbësor dhe i vetëm i vlerësimit.



Tabela 5: Shërbimet sipas tipologjisë dhe qarqeve, numër


Shërbimet sipas llojit të institucioneve	Gjithsej	Parashoqërore	Rezidenciale	Strehëza	Komunitare	Qendër zhvillimi	Qendër ditore	Familje	Të specializuara	Këshillim	Situatë emergjence	Kujdes alternativ
Berat	55	13	3	1	5	4	10	4	7	2	5	1
Durrës	99	24	7	5	16	7	9	12	11	5	1	2
Dibër	48	13	0	1	10	3	8	4	3	2	4	0
Elbasan	128	24	5	2	19	10	20	15	14	4	11	4
Fier	56	13	1	0	14	2	12	6	2	1	5	0
Gjirokastër	33	11	2	0	6	2	2	3	1	1	2	3
Korçë	214	27	14	6	28	11	27	31	20	18	25	7
Kukës	21	6	0	1	3	1	2	0	1	2	4	1
Lezhë	33	7	3	0	2	1	7	3	2	0	6	2
Shkodër	130	27	18	2	22	0	6	10	20	1	13	11
Tiranë	256	59	26	11	27	15	35	7	29	16	28	3
Vlorë	74	14	4	1	11	4	10	4	10	9	6	1
<b>Shuma</b>	<b>1,147</b>	<b>238</b>	<b>83</b>	<b>30</b>	<b>163</b>	<b>60</b>	<b>148</b>	<b>99</b>	<b>120</b>	<b>61</b>	<b>110</b>	<b>35</b>

Burimi: Studimi, Maj 2023

Analiza e thelluar e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel bashkie është jo vetëm domethënëse në raport me qëllimin e këtij studimi, por edhe funksionale sepse ofron - evidenca të mirë argumentuara mbi drejtimit në të cilat bashkitë dhe partnerët e tyre duhet të orientojnë vëmëndjen për ngritjen e shërbimeve të reja si edhe forcimin e zhvillimin e shërbimeve ekzistuese.


Kështu, figurat 11, 12 dhe 13 rendisin bashkitë sipas numrit të shërbimeve që ato sigurojnë, të grupuara në tre kategori, përkatësisht: bashki që sigurojnë deri 11 shërbime, bashki që sigurojnë 12 deri 44 shërbime dhe bashki që sigurojnë mbi 44 shërbime. Grupimi është mbështetur tek numri "11 shërbime" meqenëse 11 janë tipologjitë e konsideruara, për rrjedhojë një bashki që siguron të paktën 11 shërbime ka mundësi të sigurojë të gjitha tipologjitë që kushtëzon ligji. Bashkitë që sigurojnë deri 11 shërbime, qartësisht konkludohet se kanë mungesa në tipologji shërbimesh. Megjithatë, në vijim, në kapitullin përkatës, shërbimet do të analizohen edhe sipas tipologjive edhe sipas grupeve përfituese.

Figura 11: Bashki që ofrojnë deri në 11 shërbime




Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 12: Bashki që ofrojnë 11 deri 44 shërbime



Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 13: Bashki që ofrojnë mbi 44 shërbime



Burimi: Studimi, Maj 2023

Për të plotësuar dhe përmbyllur analizën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, përdorim të dhënat e integruara të shërbimeve sipas tipologjisë dhe të grupeve që i përfitojnë këto shërbime (figura 14 dhe tabela 12 në Shtojcën 3).

Këto të dhëna dëshmojnë qartë se:

1. Të rinjtë në konflikt me ligjin, të rinjtë me probleme sociale, të pastrehët, viktimat e trafikimit dhe minoriteti Egjyptian, jo vetëm që kanë pak mundësi të përdorin shërbime të kujdesit shoqëror sepse shërbimet që adresojnë nevojat e tyre janë tepër të kufizuara, por edhe tipologjia e shërbimeve që ata mund të aksesojnë, është tepër e varfër.

Konkretisht:

2. Vetëm 0,4% e shërbimeve parashoqërore, 0,6% e shërbimeve komunitare, 0,7% e qendrave ditore, 0,8% e shërbimeve të specializuara, 1% e shërbimeve në familje dhe 1,6% e shërbimeve të këshillimit, janë të orientuara për të ndihmuar mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të të rinjve në konflikt me ligjin.

3. Po kështu, 1,2% e shërbimeve komunitare, 1,3% e shërbimeve parashoqërore, 1,6% e shërbimeve të këshillimit, 1,7% e shërbimeve të specializuara, 1,8% e shërbimeve të emergjencës dhe 2,4% e shërbimeve rezidenciale ofrohen për viktimat e trafikut.

4. Edhe "të rinjtë me probleme sociale" kanë mundësi të kufizuara të përdorin shërbime të kujdesit shoqëror. Vetëm 5,4% e shërbimeve të qendrave ditore, 4,9% e shërbimeve komunitare dhe 4,2% e shërbimeve parashoqërore, iu kushtohen të "Rinjve me probleme ekonomike dhe sociale".

5. Individët me aftësi të kufizuara (mbi 16 vjeç) gjithashtu kanë pak mundësi që të përdorin shërbime të kujdesit shoqëror. Me përjashtim të shërbimeve në "Qendër Zhvillimi" dhe në "Familje", nga të cilat "Të rritur AK" përfitojnë përkatësisht 13,3% dhe 11,1%, shërbimet e tipologjive të tjera iu shpërndahen të rriturve me aftësi të kufizuara në një numër mjaft të kufizuar.

6. I njëjti konstatim vlen edhe për "Viktimat e dhunës", të cilat me përjashtim të Shërbimeve në "Strehëza" si edhe Shërbimeve të "Emergjencës", kanë shumë pak mundësi të aksesojnë shërbime të tipologjive të tjera.


7. Individët me probleme ekonomike dhe sociale si edhe fëmijët me aftësi të kufizuara aksesojnë larmishmëri tipologjish të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

8. Të moshuarit, si kategoria e tretë, përfituese e 13% të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përdor 20% të shërbimeve rezidenciale, 19% të shërbimeve të emergjencës, 17% të shërbimeve të qendrave ditore si edhe po kaq të shërbimeve në familje.

9. Fëmijët jashtë kujdesit prindëror përdorin 43% të shërbimeve të kujdesit alternativ si edhe 28% të shërbimeve rezidenciale.

10. Konstatohet se "Shërbimet në familje" aksesohen nga thuajse të gjitha kategoritë e përfituesve, me përjashtim të të rinjve në konflikt me ligjin si dhe të viktimave të trafikut, pavarësisht se shpërndarja ndërmjet grupeve nuk është e përpjesshme. Individët e famileve me probleme ekonomike dhe sociale përdorin 38% të këtyre shërbimeve, të pasuar nga "Fëmijët me AK" dhe të "Moshuarit", përkatësisht me 17%.

**Figura 14: Të dhënat e integruara të shërbimeve sipas tipologjisë dhe grupeve përfituese, përqindje**



Burimi: Studimi, Maj 2023

Në 7 bashki, përkatësisht në Libohovë, Këlcyrë, Dropull, Memaliaj, Mirditë, Fushë-Arrëz, Himarë nuk ofrohet asnjë shërbim për asnjë grup. Në 20 bashki, përkatësisht në Kuçovë, Shijak, Skrapar, Bulqizë, Klos, Belsh, Peqin, Gramsh, Patos, Mallakastër, Divjakë, Përmet, Tepelenë, Devoll, Has, Tropojë, Vorë, Rrogozhinë, Delvinë, Konispol, ofrohen shërbime vetëm për një grup në nevojë. Në 14 bashki, përkatësisht në Poliçan, Dimal, Cërrik, Librazhd, Prrrenjas, Roskovec, Kolonjë, Kurbin, Malësi e Madhe, Pukë, Vau Dejës, Kavajë, Finiq, Selenicë, ofrohen shërbime për dy grupe në nevojë. Në 2 bashki, në Mat dhe Pustec ofrohen shërbime për 3 grupe në nevojë. Në 2 bashki të tjera, në bashkitë Kukës dhe Kamëz ofrohen shërbime për 4 grupe. Në 4 bashki, përkatësisht në Sarandë, Maliq, Fier, Dibër ofrohen shërbime për 5 grupe. Në 6 bashki, përkatësisht në Berat, Krujë, Lushnje, Gjirokastrë, Pogradec, Lezhë ofrohen shërbime për 6 grupe. Në bashkitë Vlorë dhe Durrës ofrohen shërbime për 7 grupe. Në Elbasan dhe Korçë ofrohen për 9 grupe, në Shkodër për 10 grupe, ndërsa në Tiranë ofrohen shërbime për të gjitha grupet.




# VII. PËRFITUESIT E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Analiza e të dhënave sipas "Përfituesve" synon jo vetëm të informojë në lidhje me përfituesit në numër, sipas gjinisë, grup moshës, qarqeve e bashkive, llojeve të shërbimeve dhe tipologjisë, por edhe të hulumtojë më thellë në cilësitë e grupit përfitues, nevojës së tij për mbështetje monetare apo në shërbime, për të arritur deri tek vlerësimi i nevojës në raport me popullsinë.

Figura 15 paraqit grupimin e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në përputhje me llojet e institucioneve që sigurojnë shërbimet. Siç tregon figura 15, 62% e përfituesve përfitojnë shërbime nga institucione Jo-Publike, ndërsa përfituesit e shërbimeve publike dhe të institucioneve të përziera kanë thuajse të njëjtën peshë në raport me shumën e përgjithshme të përfituesve.


Figura 15. Përfituesit e shërbimeve sipas llojit të institucioneve



Burimi: Studimi, Maj 2023

Nëse sjellim në vëmendje peshën e institucioneve dhe të shërbimeve ndaj numrit të përgjithshëm (Tabela 1), konstatojmë se ndërsa ndërmjet grupimit të institucioneve dhe shërbimeve sipas financuesit dhe mënyrës së administrimit ekziston një ndarje thuajse e përpjesshme, grupimi i përfituesve sipas financuesit të institucioneve dhe shërbimeve, dukshëm konfirmon numrin tejet të lartë të përfituesve të shërbimeve Jo-Publike në raport me ato Publike dhe të Përziera. Kjo gjetje, nxit hulumtimin në drejtim të numrit mesatar të përfituesve në secilin tip institucioni dhe shërbimi. Treguesit e llogaritur të numrit mesatar përkatësisht të institucioneve dhe shërbimeve sipas financuesit paraqiten në figurën 16.

Figura 16: Numri mesatar i përfituesve për shërbim dhe institucion, sipas financuesit të shërbimeve



Burimi: Studimi, Maj 2023

Të dhënat e figurës 16 qartësisht konfirmojnë se numri mesatar i përfituesve për çdo institucion dhe shërbim Jo-Publik është 2 herë më i lartë sesa ai i institucioneve dhe shërbimeve publike dhe të përziera. Fakti që numri mesatar i përfituesve është 2 herë më i lartë në institucionet Jo-Publike në krahasim me të tjerat, mund të tregojë për kërkesën e lartë për shërbime, për kapacitetet e kufizuara të sektorit publik, për ngurtësinë e procedurave të pranimit apo shpërndarjen e institucioneve në territor. Pavarësisht arsyeve, kjo gjetje mund dhe duhet të shërbejë për nxitjen e një diskutimi të thelluar mbi "Raportin Numër/Cilësi e shërbimeve të kujdesit shoqëror", së pari, në raport me përcaktimin në ligj të standartit të numrit mesatar të përfituesve për shërbim, dhe së dyti, në lidhje me vëzhgimin e kujdesshëm dhe të pandërprerë të mënyrës se si ofrohen shërbimet dhe si analizohet ndikimi i tyre tek qytetarët në nevojë.

Tabela 6 sjell informacion të detajuar mbi grupimin e përfituesve sipas qarqeve dhe llojit e mënyrës së administrimit e financimit të shërbimeve.



**Tabela 6: Përfituesit e shërbimeve sipas qarqeve, llojit të qendrave të përkujdesit shoqëror si edhe mënyrës së administrimit e financimit të shërbimeve, numër dhe përqindje**


Qarqet	A. Institucione publike					B. Institucione jo publike					C. Përzier
	Gjithsej	Qendrore	Qarku	Bashkia	Përzier	Gjithsej	OJF lokale	Organizata Ndërkombëtare	Privat	Përzier	
Berat	269	122	0	137	10	315		315			427
Durrës	607	74	0	502	31	1,829	848	379	55	547	745
Dibër	140		50	90		114			105	9	261
Elbasan	114	57		57		606	300	87	219		1,136
Fier	552	56		368	128	802	614		181	7	437
Gjirokastrë	274			65	209	55			55		154
Korçë	503	115		387	1	1,503	123	65	1,259	56	1,217
Kukës	121			9	122	0					149
Lezhë	0					587	394		193		238
Shkodër	1.449	137		1,312		4,892	293	1,932	2,667	0	458
Tiranë	2.579	428		2,116	35	12,055	11,543	181	331	0	350
Vlorë	480			123	357	65		5		60	1,149
<b>Shuma</b>	<b>7.098</b>	<b>989</b>	<b>50</b>	<b>5,166</b>	<b>893</b>	<b>22,823</b>	<b>14,115</b>	<b>2,964</b>	<b>5,065</b>	<b>679</b>	<b>6,721</b>
<b>Në %</b>	<b>100</b>	<b>14</b>	<b>1</b>	<b>73</b>	<b>113</b>	<b>100</b>	<b>62</b>	<b>13</b>	<b>22</b>	<b>3</b>	<b>100</b>

Burimi: Studimi, Maj 2023

Sipas Tabelës 6, 73% e përfituesve të shërbimeve publike, i përkasin Institucioneve që financohen nga bashkitë, ndërsa 62% e përfituesve të shërbimeve Jo-Publike i takojnë institucioneve që financohen nga OJF lokale.

Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror janë (figura 17) kryesisht fëmijët deri 16 vjeç (47%), të pasuar nga grup moshë 25 deri 65 vjeç. Të moshuarit mbi 65 vjeç përbëjnë vetëm 12% të përfituesve.

**Figura 17: Përfituesit e shërbimeve sipas grup moshës, %**



Burimi: Studimi, Maj 2023

Mbi 50% e përfituesve të shërbimeve janë të gjinisë femërore (53%). Tabela 7 pasqyron në mënyrë të detajuar numrin e përfituesve sipas qarqeve, gjinisë dhe grupeve.

**Tabela 7: Përfituesit e shërbimeve sipas qarqeve, grupeve dhe gjinisë, numër**

Qarqet	Individë të familjeve në nevojë		Fëmijë jashtë kujdesit prindëror		Fëmijë AK		Të rinj në konflikt me ligjin		Të rinj me probleme sociale		Të rritur AK		Viktima të dhunës	Viktima të trafikimit	Romët & Egjyptianët		Të moshuar		Përfutuesit	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra			Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Berat	312	165	12	2	125	53	10	0	45	4	110	63	12	1	196	67	188	101	1,011	468
Durrës	1,095	537	91	40	277	125	14	3	247	124	184	76	652	1	334	224	286	159	3,181	1,941
Dibër	150	67	30	10	69	35			80		23	14			12	2	151	86	515	214
Elbasan	774	294	35	11	342	146			30	5	326	162	117		45	4	187	89	1,856	828
Fier	742	418	43	19	241	111	1		216	87	56	31	69	5	204	65	214	50	1,791	855
Gjirokastrë	194	56	15	2	86	31							40		10		138	35	483	164
Korçë	1,362	799	43	13	235	115			89	31	194	67	130	2	577	107	591	200	3,223	1,464
Kukës	165	70			36	13					9	1	11		1	1	58	14	280	110
Lezhë	240	141	35	14	24	13	0	0	46	18	33	11	0	0	387	172	60	21	825	390
Shkodër	3,796	2,603	150	65	300	143	220	34	418	134	200	81	275	118	639	225	683	277	6,799	3,955
Tiranë	6,161	4,780	2,599	1,004	786	342	889	12	993	132	1,123	334	564	96	942	415	831	422	14,984	8,101
Vlorë	226	141	167	65	141	76	11	0	157	45	107	52	400	105	132	0	248	88	1,694	972
<b>Shuma</b>	<b>15,217</b>	<b>10,071</b>	<b>3,220</b>	<b>1,245</b>	<b>2,662</b>	<b>1,203</b>	<b>1,145</b>	<b>49</b>	<b>2,321</b>	<b>580</b>	<b>2,365</b>	<b>892</b>	<b>2,270</b>	<b>328</b>	<b>3,479</b>	<b>1,282</b>	<b>3,635</b>	<b>1,542</b>	<b>36,642</b>	<b>19,462</b>
<b>Në %</b>	<b>42</b>	<b>66</b>	<b>9</b>	<b>39</b>	<b>7</b>	<b>45</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>25</b>	<b>6</b>	<b>38</b>	<b>6</b>	<b>1</b>	<b>9</b>	<b>37</b>	<b>10</b>	<b>42</b>	<b>100</b>	<b>53</b>


Burimi: Studimi, Maj 2023

Tabela 7 gjithashtu tregon se:

- Individët në nevojë, fëmijët AK, komuniteti etnik Rom dhe Egjptian dhe të moshuarit janë grupet që përfitojnë shërbime në çdo qark të vendit.
- Fëmijët jashtë kujdesit prindëror dhe të "Rriturit AK" përfitojnë shërbime në 11 qarqe nga 12. Në Kukës dhe në Gjirokastrë nuk ofrohen shërbime përkatësisht për secilin grup.
- Viktimat e dhunës dhe të "Rinj të me probleme sociale" përfitojnë shërbime në 10 qarqe të vendit. Në Dibër dhe Lezhë, përkatësisht për "Viktimat e dhunës" dhe në Gjirokastrë e Kukës, për të "Rinj të me probleme sociale" nuk ofrohen shërbime.
- Të rinjtë në konflikt me ligjin përfitojnë shërbime në 5 nga 12 qarqet e vendit.

Figura 18 ilustron peshën në përqindje të përfituesve të secilit grup ndaj totalit si edhe peshën në përqindje të përfituesve të gjinisë femërore ndaj grupit përkatës.

**Figura 18: Përfituesit sipas grupeve dhe gjinisë, %**




Burimi: Studimi, Maj 2023

Siç tregon figura 18, përfituesit e gjinisë femërore mbizotërojnë ndaj gjinisë mashkullore, tek grupi “Individë në familje në nevojë”, si edhe tek grupet e Viktimave të dhunës dhe të trafikut, por këto janë grupe me numër të kufizuar përfituesish. Në të gjitha grupet e tjera, pesha në përqindje e përfituesve “femra” është më e vogël se sa ajo e meshkujve.

Figura 19 ilustron më tej përbërjen e përfituesve sipas qarqeve dhe gjinisë, duke treguar se pesha në përqindje e përfituesve të gjinisë femërore është afërsisht e njëjtë në të gjitha qarqet e vendit, me përjashtim të Durrësit dhe Shkodrës. Gjithashtu në Vlorë, Tiranë, Shkodër dhe Durrës pesha e përfitueseve femra është më e lartë se sa pesha e përfituesve meshkuj. Në të gjitha qarqet e tjera të vendit, pesha e përfituesve “meshkuj” është më e lartë se sa ajo e femrave, ndonëse diferenca ndërmjet dy niveleve është e ulët.

Figura 19: Përfituesit sipas qarqeve dhe gjinisë, %



Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 20 plotëson informacionin mbi përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror sepse paraqit grupet e përfituesve si edhe shërbimet që ato përfitojnë. Figura 20 është ndërtuar bazuar tek të dhënat e tabelës 8, e cila e paraqit informacionin të detajuar sipas qarqeve.




Tabela 8: Shërbimet sipas grupeve të përfituesve si edhe përfituesit në numër, sipas qarqeve

Qarqet	Individë të familjeve në nevojë		Fëmijë jashtë kujdesit prindëror		Fëmijë AK		Të rinj në nevojë		Të rritur AK		Viktima të dhunës dhe trafikimit		Romët & Egjyptianët		Të moshuar		Përfituesit	
	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime	Përfitues	Shërbime
Berat	520	16			125	13	55	2	110	8	13	8			188	8	1,011	55
Durrës	1,095	18	91	13	277	28	261	1	184	10	653	7	334	15	286	7	3,181	99
Dibër	192	21			69	13	80	3	23	7					151	4	515	48
Elbasan	774	34	35	8	342	56	30	3	326	5	117	5	45	5	187	12	1,856	128
Fier	785	16			241	9	217	11	56	2	74	7	204	2	214	9	1,791	56
Gjirokastrë	194	14	15	4	86	5					40	5	10	1	138	4	483	33
Korçë	1,362	74	43	9	235	25	89	6	194	26	132	19	577	10	591	45	3,223	214
Kukës	175	6			36	5					11	6			58	4	280	21
Lezhë	319	9	35	9	24	3							387	8	60	4	825	33
Shkodër	3,796	60	150	15	300	14	638	15	200	4	393	8	639	5	683	9	6,799	130
Tiranë	6,161	79	2,599	32	786	63	1,882	13	1,123	4	660	23	942	8	831	34	14,984	256
Vlorë	226	9	167	5	141	16	168	4	107	3	505	23	132	0	248	14	1,694	74
<b>Shuma</b>	<b>15,599</b>	<b>356</b>	<b>3,135</b>	<b>95</b>	<b>2,662</b>	<b>250</b>	<b>3,420</b>	<b>58</b>	<b>2,323</b>	<b>69</b>	<b>2,598</b>	<b>111</b>	<b>3,270</b>	<b>54</b>	<b>3,635</b>	<b>154</b>	<b>36,642</b>	<b>1,147</b>
<b>Në %</b>	<b>43</b>	<b>31</b>	<b>9</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>22</b>	<b>9</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>10</b>	<b>9</b>	<b>5</b>	<b>10</b>	<b>13</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 20: Grupet e përfituesve dhe shërbimet që përfitojnë në përqindje




Burimi: Studimi, Maj 2023

Siç vërehet nga figura 20, përqindje e përfituesve ndaj totalit nuk përputhet me përqindjen e shërbimeve në funksion të tyre. Kështu, 43% e përfituesve (Individë të familjeve në nevojë) përfitojnë vetëm 31% të shërbimeve. Po kështu, edhe "të Rinjtë në nevojë" si edhe "Romët dhe Egjyptianët". Ndërsa shërbimet për "Fëmijët AK", të "Moshuarit" dhe "Viktimat e dhunës" përbëjnë një përqindje më të lartë ndaj totalit të shërbimeve se sa grupi për të cilin këto shërbime ofrohen. Kjo gjetje e thjeshtë mund të jetë rrjedhojë e vendimeve të rastësishme, të kushtëzuara nga rrethanat ose nga mundësitë e financimit të shërbimeve. Sidoqoftë, planifikimi i shërbimeve duhet të udhëhiqet nga vlerësimi i nevojës.

Figura 21 paraqit renditjen e qarqeve sipas numrit të përfituesve, e cila ndryshon pak nga renditja e shërbimeve të ofruara në secilin qark (Figura 3). Sidoqoftë, çështja themelore nuk është numri i shërbimeve apo i përfituesve në çdo qark të vendit, sepse numri i përfituesve deri diku është i kushtëzuar nga numri i shërbimeve funksionale, të cilat mund të aksesojnë individët në nevojë.

Figura 21: Renditja e qarqeve sipas numrit të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror




Burimi: Studimi, Maj 2023

Problemet themelore që motivojnë ndërmarrjen e studimeve të tilla, si “Hartëzimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror”, janë më komplekse, sepse kërkojnë të hulumtojnë thellë në përmbajtjen e faktorëve të cilët kushtëzojnë:

- Pamjaftueshmërinë e shërbimeve në numër
- Larmishmërinë e tipologjisë, në përputhje me nevojën
- Shpërndarjen e shërbimeve sipas dimensionit gjeografik
- Mundësinë e qytetarëve për të aksesuar shërbimet
- Cilësinë dhe koston e shërbimeve.

Për të kontribuar sadopak në trajtimin e problemeve të mësipërme, janë analizuar tregues të drejtëpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë. Kësisoj, është llogaritur treguesi i “Përfituesve për 100 mijë banorë” (figura 22) e më tej, ky tregues është krahasuar me treguesin e shërbimeve për 100 mijë banorë. Gjithashtu është llogaritur edhe treguesi i numrit mesatar të përfituesve për një shërbim, sipas qarqeve dhe në nivel kombëtar (figura 23).

Figura 22: Renditja e qarqeve sipas treguesit të përfituesve për 100 mijë banorë




Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 22 paraqit renditjen e qarqeve sipas treguesit “Përfitues për 100 mijë banorë”. Ky është një tregues i llogaritur, jo i drejtëpërdrejtë, i krijuar për qëllim të këtij studimi. Sipas këtij treguesi, qarku Kukës është qarku me numrin më të vogël të përfituesve për 100 mijë banorë, ndërsa Shkodra është qarku me numrin më të lartë të përfituesve, çka dëshmon një gjetje kontradiktore: Numri i përfituesve për 100 mijë banorë është i ulët në qarkun e Kukësit sepse qytetarët nuk kanë nevojë për shërbime apo sepse nuk ka shërbime? Edhe pa bërë llogaritje të tjera, mund të perceptohet se arsyeja e vërtetë është pamjaftueshmëria e shërbimeve, pasi në Kapitullin VI kjo çështje u analizua gjerësisht dhe qartësisht u tregua se shërbimet ekzistuese janë të pamjaftueshme.

Megjithatë, për të argumentuar në mënyrë të qëndrueshme gjetjet e studimit, plotësojmë kuadrin edhe me një tregues tjetër jo të drejtëpërdrejtë, treguesin “ Përfitues/Shërbime për 100 mijë banorë”. Meqenëse më lart (figura 5) u paraqit numri i shërbimeve për 100 mijë banorë, lehtësisht ndërtojmë figurën 23, e cila paraqit renditjen e qarqeve sipas treguesit “ Përfitues/Shërbime për 100 mijë banorë”.

Figura 23: Përfitues/Shërbime për 100 mijë banorë



Burimi: Studimi, Maj 2023


Sipas të dhënave të figures 23, Qarku Dibër është qarku me vlerën më të ulët të treguesit, ndërsa qarku Tiranë është ai me vlerën më të lartë. Cili është kuptimi i këtij treguesi dhe efektiviteti i përdorimit të tij?

Treguesi dëshmon se në Tiranë mesatarisht një shërbim i përkujdesit shoqëror përfitohet nga rreth 6 herë më shumë përfitues se sa në Dibër, gjë e cila qartësisht dëshmon për nevojën për shërbime në Tiranë disa herë më të lartë se sa në Dibër (qarku me vlerën më të ulët të treguesit), por edhe për kapacitetet ofruese në Tiranë, disa herë më të shumta se sa në Dibër, pra për faktin se mundësia e aksesimit të shërbimeve është shumë më e lartë në Tiranë se sa në Dibër.

Megjithatë çështja e shkallës së plotësisht të nevojës ende nuk është hulumtuar plotësisht. Pra, treguesi, edhe pse informativ, nuk pasqyron plotësisht nëse vlera e ulët e treguesit në Dibër dëshmon edhe për shkallën e ulët të nevojës të qytetarëve për shërbime të përkujdesit shoqëror. Gjithashtu, treguesi nuk dëshmon edhe nëse, në Tiranë, megjithë numrin e lartë të përfituesve për një shërbim, arrihet të plotësohet nevoja për shërbime të përkujdesit shoqëror. Përkundrazi, bindshëm gjykohet se “Nevoja për shërbime të përkujdesit shoqëror nuk plotësohet as në Tiranë, as në Dibër, sepse në Tiranë ka shumë më tepër kërkues se sa kapacitete në përdorim, ndërsa në Dibër nuk ka kapacitete institucionale”. Pra vlerësimi se treguesi i zgjedhur sjell informacion kontradiktor qëndron pikërisht në faktin që në njërin anë ky tregues dëshmon për numrin e lartë të kërkuesve të shërbimit, pra për nivelin e lartë të kërkesës, ndërsa në anën tjetër dëshmon për shkallën e ulët të plotësisht të nevojës.

Për të ndihmuar në gjykimin e shëndoshë dhe real të “Nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror”, analizojmë edhe dy tregues të tjerë, jo të drejtëpërdrejtë, përkatësisht “Përfitues të ndihmës monetare për 1 mijë banorë” dhe “Përfitues të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për 1 mijë banorë” (figura 24) në çdo bashki dhe qark të vendit. Për shkak të pamundësisë për të paraqitur në figurë apo tabelë të gjitha bashkitë e vendit (të dhënat mbi bashkitë janë paraqitur tek tabela 14 në Shtojcën 3) këtu paraqiten të përmbledhura vetëm rezultatet e qarqeve. Sidoqoftë, gjetjet dhe komentet analitike vlejné edhe për bashkitë.

Figura 24: Përfitues për 1 mijë banorë të ndihmës monetare dhe shërbimeve




Burimi: Studimi, Maj 2023

Treguesit e mësipërm, të pasqyruar tek figura 24 janë përdorur, në pamundësi për të organizuar dhe realizuar një studim të mirfilltë të vlerësimit të nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror. Sipas teorive të mbrojtjes shoqërore, pavarësisht akordimit të ndihmës monetare, përfituesit e ndihmës monetare gjykohet që janë grupi i parë që mund të kenë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror. Në këtë studim, tek treguesi “Përfitues të Ndhmës Monetare”

janë përfshirë vetëm përfituesit e Ndhmës Ekonomike dhe ata të Pagesës së Aftësisë së kufizuar. Vlerësimi teorik ka bazë llogjike, sepse nëse programet e sotme të ndihmës dhe mbrojtjes shoqërore synojnë përfshirjen sociale, atëherë shërbimet e përkujdesit shoqëror, gjithëpërfshirëse dhe integruese duhet të ofrohen përfituesve të ndihmës monetare, si kategori në nevojë, lehtësisht e identifikueshme.

Të dhënat e figures 24 dëshmojnë se “përfituesit e shërbimeve” janë grup thuajse i papërfillshëm në krahasim me përfituesit e ndihmës monetare. Renditja e qarqeve sipas shkallës së kritikitetit, e vlerësuar si raport ndërmjet Treguesit “Përfitues të Ndhmës Monetare” me “Përfitues të Shërbimeve” paraqitet tek Figura 25.

Figura 25: Treguesi Përfitues-Ndhmë Monetare/Përfitues-Shërbime, Raport



Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 25 përforcon argumentin se shërbimet jo vetëm janë të pamjaftueshme në çdo qark të vendit, por edhe shkalla e pamjaftueshmërisë është thellësisht e pabarabartë. Ndryshimi në mundësitë e qytetarëve për të aksesuar shërbime në Kukës (qarku më kritik) është rreth 40 herë më e vogël se sa mundësia e qytetarëve për të aksesuar shërbime në Durrës (qarku me mundësitë më të mëdha për të aksesuar shërbime).

Përfundimisht, analiza e situatës së shërbimeve të përkujdesit shoqëror e plotësuar me analizën e përfituesve, qartësisht lejon formulimin e gjetjeve që vijojnë:

- Shërbimet e përkujdesit shoqëror si në numër e tipologji janë të pamjaftueshme.
- Shpërndarja e shërbimeve të përkujdesit shoqëror nuk është e njëtrajtshme nga pikëpamja gjeografike dhe as në përputhje me nevojën apo probleme të tjera ekonomike e sociale të zonave të vendit.
- Shërbimet e përkujdesit shoqëror sipas grupeve përfituese nuk reflektojnë plotësisht nevojat e grupeve meqenëse ka grupe për të cilat shërbime ofrohen në shumicën e bashkive të vendit, ndërsa ka grupe të tjera për të cilat ofrohen shumë pak ose nuk ofrohet asnjë shërbim. Mbi të gjitha, ofrimi i shërbimeve nuk është i kushtëzuar nga studimi dhe analiza e nevojës për shërbime.
- Shërbimet e përkujdesit shoqëror janë ende “të papërcaktuara qartë” në atë që nuk përputhen ende me nevojën e përgjithshme dhe specifike të qytetarëve për shërbime.



# VIII. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE DHE INSTITUCIONALE

## NË FUNKSION TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Analiza e kapaciteteve institucionale, financiare dhe njerëzore në funksion të sigurimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, është një element i ri, i shtuar në Hartëzimin e vitit 2023, me qëllim që përveç argumentimit mbi shërbimet dhe shpërndarjen e tyre, apo nevojën e paplotësuar për shërbime të përkujdesit shoqëror, të evidentohen edhe kapacitetet, për të gjykuar saktë e plotësisht mbi mundësitë për rritjen e shkallës të mbulimit me shërbime të cilësishme të përkujdesit shoqëror, por edhe më tej, në realizimin e të drejtës së qytetarëve për përfshirje sociale.

Sot në Shqipëri, janë 3,753 punonjës, që planifikojnë, administrojnë, sigurojnë dhe ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në të gjithë vendin, në bashki dhe institucione të përkujdesit shoqëror, qofshin publike, private ose të përziera. 78% e tyre ose 2,916 punonjës janë drejtëpërsëdrejti të angazhuar me funksionimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucione, ndërsa 22% ose 837 punonjës mbështesin funksionimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në bashkitë e vendit. 81% e administratës së shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucione është e gjinisë femërore.

Ndërsa tabela 15 te Shtojca 3 paraqet të detajuar informacionin në çdo bashki të vendit, këtu paraqitet dhe analizohet përmblendhja e tij, jo vetëm në planin e “kapaciteteve” por edhe në lidhjen e tij me “shërbimet” dhe “përfituesit”.

Tabela 9 sjell të dhëna të plota mbi stafin e institucioneve, si edhe përbërjen e tij sipas gjinisë, funksionit, arsimit dhe tipit të kontratës. Siç konstatohet, 81% e stafit të institucioneve i përket gjinisë femërore, ndërsa 67% e stafit është me arsim të lartë. Gjithashtu 67% e stafit është e angazhuar në sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, 23% është staf mbështetës, ndërsa drejtuesit përbëjnë 10% të të gjithë burimeve njerëzore. 85% e stafit është i angazhuar me kontratë me kohë të plotë, ndërsa pjesa tjetër, me kontratë me kohë të pjesshme. Vlen për t’u nënvizuar fakti se 214 punonjës janë të angazhuar si vullnetarë, në institucionet e tre qarqeve të vendit, përkatësisht në Korçë (16 vullnetarë), Shkodër (46 vullnetarë) dhe Tiranë (152 vullnetarë). Kjo kategori nuk është llogaritur në shumën e përgjithshme të burimeve njerëzore meqenëse është e angazhuar në mënyrë të përkohshme dhe/ose sezonale.






Tabela 9: Kapacitetet administrative, burimet njerëzore që sigurojnë shërbimet e përkujdesit shoqëror në institucione

Qarqet	Staf në institucione të Përkujdesit Social sipas									
	Gjithsej	Femra	Funksionit			Arsimit			Kontratës	
			Drejtues	Mbështetës	Bashkitë	I Lartë	I Mesëm	Bazë	I plotë	I pjesëm
Berat	75	55	10	17	48	28	44	3	41	34
Durrës	278	243	30	88	160	176	94	8	234	44
Dibër	65	49	10	16	39	40	22	3	53	12
Elbasan	197	159	29	15	153	134	52	11	192	5
Fier	154	123	20	21	113	95	46	13	136	18
Gjirokastrë	85	73	12	13	60	69	14	2	74	11
Korçë	287	218	30	39	218	190	91	6	242	45
Kukës	16	16	3	2	11	14	2		16	
Lezhë	82	64	11	21	50	59	21	2	82	
Shkodër	470	366	31	69	370	294	161	15	381	89
Tiranë	1,018	832	89	331	598	722	275	21	871	147
Vlorë	189	171	18	39	132	139	40	10	164	25
<b>Shuma</b>	<b>2,916</b>	<b>2,369</b>	<b>293</b>	<b>671</b>	<b>1,952</b>	<b>1,960</b>	<b>862</b>	<b>94</b>	<b>2,486</b>	<b>430</b>
<b>Në %</b>	<b>100</b>	<b>81</b>	<b>10</b>	<b>23</b>	<b>67</b>	<b>67</b>	<b>30</b>	<b>3</b>	<b>85</b>	<b>15</b>

Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 26 ilustron më tej përbërjen e stafit të përgjithshëm të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, sipas arsimit. Siç konstatohet, punonjësit me arsim të lartë dominojnë si nëpër bashki ashtu edhe nëpër institucione, përkatësisht 95% e stafit të bashkive dhe 67% e stafit të institucioneve të përkujdesit shoqëror.

Figura 26: Burimet njerëzore të përgjithshme të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, sipas arsimit, %




Burimi: Studimi, Maj 2023

Edhe analiza sipas stafit të dedikuar tek sigurimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe përfituesve të shërbimeve dëshmon se kapacitetet njerëzore janë mëse të mjaftueshme në numër dhe formim për të siguruar shërbime të cilësishme (figurat 27 dhe 28).

Figura 27 mbështet idenë se burimet njerëzore të institucioneve të përkujdesit shoqëror kudo në Shqipëri janë të mjaftueshme për të siguruar shërbime të cilësishme nëpër institucione sepse çdo punonjësi i takon të kujdeset mesatarisht për 6 (Gjirokastra) deri 18 (Kukësi) përfitues shërbimesh, plotësisht e mundshme dhe e arritshme. Sidoqoftë, kjo gjetje duhet të krahasohet me standartet e miratuara të shërbimeve të përkujdesit shoqëror si edhe me vlerësimin e performancës të stafeve përkatëse, për të konkluduar nëse burimet njerëzore të institucioneve janë të mjaftueshme apo të pamjaftueshme.


Figura 27: Treguesi Përfitues/Staf, Institucionet e Kujdesit Shoqëror, numër



Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 28 mbështet të njëjtin argument, por tashmë duke konsideruar administratën e bashkive, dedikuar sigurimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Këtu nuk janë konsideruar përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por përfituesit e shërbimeve në bashki, përfshirë ndihma monetare. Rezulton se mesatarisht një punonjës duhet të kujdeset për 117 (Gjirokastra) deri 1.448 (Kukësi) përfitues. Me përjashtim të Kukësit, në të gjitha qarqet e tjera, të paktën në vlerësim sipërfaqësor, situata ngjan e menaxhueshme.

Figura 28: Treguesi Përfitues/Staf në Bashki, sipas qarqeve, numër



Burimi: Studimi, Maj 2023


Në kontraditë me këto përfundime, të paktën për kapacitetet e bashkive, qëndrojnë disa të dhëna të tjera, të mbledhura në funksion të qëllimit të këtij studimi.

Konkretisht:

- **Shkalla e krijimit të strukturave të posaçme në bashki në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të përkujdesit shoqëror, ofruar qytetarëve.** Studimi tregoi se NJVNR janë krijuar vetëm në 14 Bashki, NJMF në 34 bashki, MKR në 44 bashki, Personi përgjegjës për Komunitetin Rom në 25 bashki, Personi përgjegjës për Aftësinë e Kufizuar në 33 bashki dhe sistemi MIS në 31 bashki. Vetëm bashkitë Elbasan dhe Tiranë i kanë krijuar të gjitha strukturat e sipërpërmendura, ndonëse bashkia Tiranë nuk përdor sistemin MIS për menaxhimin e të dhënave por sistemin Opendata.
- **Numri i trainimeve të ofruara, tematika dhe numri i specialistëve të trajnuar.** Figurat 29 dhe 30 ilustrojnë të dhënat në nivel kombëtar. Të dhënat e përmbledhura dëshmojnë se edhe pse numri i trainimeve dhe personave të trajnuar është rritur në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, përsëri 3 deri 5% e administratës është trajnuar, në secilën nga tematikat e përzgjedhura dhe të konsideruara si thelbësore për përmirësimin e funksionimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- **Përdorimi i aplikimit për Fondin Social,** si një mekanizëm efektiv për rritjen e mundësive të bashkive për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Vetëm 21 nga 61 bashki (34%) kanë aplikuar të paktën një herë për mbështetje nga fondi social. Në Qarkun Dibër asnjë nga bashkitë nuk ka aplikuar. Në qarqet Berat, Durrës, Fier, Kukës, vetëm një nga bashkitë ka aplikuar, kryesisht bashkitë-qendër e qarqeve, me përjashtim të qarkut Fier, në të cilin bashkia Patos ka aplikuar për financim. Në qarqet Elbasan, Lezhë, Gjirokastrë dhe Shkodër, kanë aplikuar nga 2 bashki, përkatësisht bashkitë Belsh, Gramsh, Lezhë, Kurbin, Gjirokastrë, Tepelenë, Shkodër dhe Malësi e madhe. Vetëm në qarqet Tiranë, Vlorë dhe Korçë kanë aplikuar nga tre bashki, përkatësisht: Tiranë, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë, Delvinë, Sarandë, Pogradec, Kolonjë dhe Maliq. Pjesa më e madhe e bashkive që kanë aplikuar, kanë përfituar mbështetje nga Fondi Social dhe do të vazhdojnë të aplikojnë me projekte të reja. Megjithatë, bashkitë konsiderojnë “dobësinë e kapaciteteve në drejtim të shkrimit të projekteve” si pengesën kryesore për sigurimin e burimeve alternative për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Figura 29 ilustron numrin mesatar të trainimeve të realizuara në secilën bashki në vitin 2021 dhe vitin 2022. Nga katër tematikat e ofruara rezulton se në “Aplikimin e standarteve për vlerësimin e nevojave” dhe “menaxhimin e rasteve” janë realizuar më shumë trainime, përkatësisht 1,5 dhe 0,8 trainime mesatarisht për çdo bashki. Sidoqoftë, numri i trainimeve është tejet i ulët.


Figura 29: Numri mesatar i trainimeve të realizuara në secilën bashki në një vit



Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 30 paraqit pjesën e administratës së shërbimeve sociale në bashki që ka marrë pjesë në trainime, e shprehur në përqindje. Edhe ky tregues dëshmon për një pjesëmarrje tejet të ulët, jo më shumë se 5% e administratës.

Figura 30: Përqindja e administratës së shërbimeve sociale në bashkitë e vendit, që ka marrë pjesë në trainime



Burimi: Studimi, Maj 2023

Në përfundim të vlerësimit cilësor, secili nga të intervistuarit iu përgjigj pyetjeve që synonin të identifikonin çështjet më kritike në lidhje me vlerësimin e mundësisë së qytetarëve në nevojë për të përdorur shërbime sociale. Çështjet e përzgjedhura për vlerësim ishin:

- Pamjaftueshmëria e shërbimeve në lidhje me nevojën për të referuar rastet e identifikuar.
- Mbulimi i njëtrajtshëm i zonës urbane dhe rurale në bashki, me shërbime të mjaftueshme.
- Kushtëzimi i cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga mungesa e fondeve.
- Kushtëzimi i cilësisë së shërbimeve që ofrohen nga mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara.
- Vështirësitë në mbulimin e kostove të familjeve për të aksesuar shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

Analiza e të dhënave tregon se:

- Për 8 qarqe, përkatësisht Berat, Durrës, Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, çështja e kostos të papërbalueshme nga ana e familjeve për të përballuar nevojën e aksesimit të shërbimeve për individët me aftësi të kufizuara, është problemi më kritik.
- Për 4 qarqet e tjera, vlerësimet janë të ndryshme. Për bashkitë e qarkut Elbasan, çështja e pamjaftueshmërisë të shërbimeve në përputhje me nevojën dhe pamundësia e stafit për të referuar rastet, është çështja më kritike. Të njëjtin mendim ndajnë edhe përfaqësuesit e bashkive të qarkut Kukës, por në këtë qark, edhe çështja e mungesës së fondeve, si një faktor që kushtëzon cilësinë e shërbimeve, konsiderohet kritike.
- Çështja e mungesës së fondeve dhe ndikimi i saj në kushtëzimin e cilësisë së shërbimeve konsiderohet problemi më kritik edhe për bashkitë e qarkut Fier dhe Lezhë.
- Për 7 qarqe, përkatësisht për Berat, Dibër, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Tiranë, mungesa e fondeve si faktor pengues në ofrimin e shërbimeve të cilësishme, është faktori i dytë kritik. Për qarqet e tjera, vlerësimet janë të ndryshme. Për bashkitë e qarqeve Durrës dhe Vlorë, diskriminimi i zonës rurale në krahasim me zonën urbane në drejtim të mbulimit me shërbime, është faktori i dytë për nga kriticiteti. Për bashkitë e qarqeve Elbasan dhe Fier, kosto e lartë e aksesimit të shërbimeve për aftësinë e kufizuar, është faktori i dytë më kritik. Për bashkitë e qarkut Kukës, mungesa e fondeve dhe ndikimi i saj në cilësinë e shërbimeve, është faktori i dytë kritik, ndërsa për bashkitë e qarkut Lezhë, pamjaftueshmëria e shërbimeve është tejet e rëndësishme.
- Sa i përket faktorit më pak kritik, bashkitë e qarqeve Durrës, Dibër, Shkodër dhe Tiranë ndajnë mendimin se kualifikimi i burimeve njerëzore është i mjaftueshëm për të ofruar shërbime të cilësishme, pra nuk konsiderohet kritik. Qarku Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë nuk e konsideron kritik pamjaftueshmërinë e shërbimeve në raport me menaxhimin e rasteve, Bashkitë e qarkut Kukës dhe Lezhë konsiderojnë pak të rëndësishme çështjen e kostos së shërbimeve të aftësisë e kufizuar, ndërsa bashkitë e qarkut Elbasan, nuk e konsiderojnë shqetësuese çështjen e mbulesës së njëtrajtshme me shërbime në zonën urbane dhe rurale.



# IX. VLERËSIMI I NEVOJËS PËR SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR

Vlerësimi i nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror është një çështje e konsideruar kritike prej kohësh. Sigurisht që për të vlerësuar nevojën do të duhej të organizohej një studim i mirfilltë kombëtar. Por, nga ana tjetër, mbase një studim i tillë nuk do të arrinte të vlerësonte nevojën në çdo bashki të vendit, edhe pse do të ravijëzonte grupet dhe nevojat më kritike në nivel kombëtar. Për rrjedhojë, prej disa vitesh, përdoren metoda të tërthorta për të vlerësuar nevojën për shërbime të përkujdesit shoqëror, metoda të cilat janë konsideruar instrumenta efektivë përgjatë përgatitjes të planeve sociale të çdo bashkie.

Kësisoj, edhe në këtë studim, u ndoq praktika e planeve sociale dhe u përdorën të njëjtat instrumenta për vlerësimin e nevojës për shërbime të përkujdesit shoqëror. Këto instrumenta (shih "Metodologjia", kapitulli V) mundësuan mbledhjen e të dhënave nga burime dytësore (statistikore, statistika të bashkive dhe qarqeve), të nëngrupuara sipas grupeve në nevojë më kritike dhe gjinisë, rreth:

- Ndhimës ekonomike.
- Aftësisë së kufizuar.
- Papunësisë.
- Pensioneve.
- Strehimit.

Si edhe në kapitujt e tjerë, të dhënat e detajuara paraqiten tek Shtojca 3 (tabela 16), ndërsa përmbledhja e të dhënave, e shoqëruar me analizën përkatëse, trajton në raport çështjet që vijojnë:


- Vlerësim i peshës së individëve në nevojë në raport me popullsinë e vendit, sipas qarqeve dhe gjinisë.
- Vlerësim i grupeve më kritike, sipas peshës së tyre ndaj numrit të përgjithshëm të individëve në nevojë.
- Vlerësim i peshës së përfituesve të shërbimeve përkundrejt nevojës.
- Vlerësim i shërbimeve të munguara në çdo bashki të vendit.

Me përjashtim të çështjes së fundit, analiza e të gjitha çështjeve të tjera mbështetet nga të dhëna statistikore, domethënë të dhëna të burimeve dytësore. Analiza e çështjes së fundit bazohet tek të dhënat e burimeve parësore, të mbledhura gjatë këtij studimi, nëpërmjet instrumentave të vlerësimit cilësor të sqaruara tek Metodologjia.

Tabela 10 dhe Figura 31 pasqyrojnë peshën e individëve në nevojë për shërbime, për shkak të statusit të tyre si përfitues/aplikues të ndihmës ekonomike, aftësisë së kufizuar, invaliditetit, papunësisë, statusit të strehimit dhe të pensionistit. Me përjashtim të kategorisë "Pensionsitë", të gjitha kategoritë e tjera kanë nevojë për shërbime të

mbrojtjes dhe të përkujdesit shoqëror. Kategoria "Pensionistë" është përfshirë (edhe pse jo të gjithë pensionistët kanë domosdoshmërisht nevoja ekonomike ose sociale) duke konsideruar së pari faktin se qeveria ka ndërmarrë hapa seriozë drejt politikave të sigurimit të shërbimeve të integruara për të moshuarit. Së dyti, pensionsitët kanë të paktën nevoja për shërbime shëndetsore. Së treti, "të moshuarit" janë kategori përfituese e shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Së katërti, edhe nëse të gjithë pensionistët nuk janë domosdoshmërisht në nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, pensionsitët përfitues të pensioneve të fshatit si edhe të atyre sociale, janë sigurisht në nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror. Nga ana tjetër, fenomeni i tkurrjes demografike si edhe i emigracionit, ka nxjerrë në pah nevojën për vëmendje ndaj të moshuarve, pavarësisht situates së tyre ekonomike.

Figura 31: Individë në nevojë për shërbime ndaj popullsisë, sipas qarqeve, %



Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 31 tregon se nevoja për shërbime është më e lartë edhe se sa mesatarja e vendit në qarqet Kukës, Dibër e Shkodër, është pranë mesatares së vendit në qarqet Korçë, Fier, Elbasan dhe Berat, është më e ulët se sa mesatarja e vendit në qarqet Vlorë dhe Lezhë, ndërsa është shumë më e ulët se sa mesatarja e vendit në qarqet Tiranë, Durrës dhe Gjirokastrë.

Vlerësimi i nevojës për shërbime konsideroi edhe vlerësimin e nevojës sipas grupeve më kritike, përkatësisht:

- Individë në kushte kritike ekonomike e sociale (Individë në NE, Fëmijë AK, Fëmijë, Të Moshuar, Gra të vetme kryefamiljare)
- Fëmijë në kushte kritike ekonomike e sociale (Fëmijë NE + Fëmijë të pastrehë)
- Gra në kushte kritike ekonomike e sociale (Gra të vetme NE + Gra të papuna)
- Individë me Aftësi të Kufizuar (Individë AK - Fëmijë AK)
- Fëmijë me Aftësi të Kufizuar
- Të rinj në kushte kritike ekonomike e sociale (Të rinj nën 25 vjeç, pa punë)
- Të moshuar në kushte kritike ekonomike e sociale (Moshuar NE + Moshuar pa strehë + Moshuar pension fshati + Moshuar pension social).


Tabela 10: Individët në nevojë sipas gjinisë, si edhe në % ndaj popullsisë

Bashkitë sipas qarqeve	Individë në nevojë		Individë në nevojë në % të popullsisë		Përfitues shërbimesh/cash në %	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
<b>1. Berat</b>	<b>47,464</b>	<b>23,704</b>	<b>20.1</b>	<b>21.0</b>	<b>2.2</b>	<b>2.0</b>
Berat	24,767	12,445.0	24.8	25.1	3.2	3.16
Kuçovë	12,019	5,878.0	14.7	14.9	0.1	0.07
Poliçan	3,869	2,091.0	35.3	41.4	4.3	2.43
Skrapar	5,261	2,590.0	33.0	34.0	0.2	0.12
Dimal	1,548	700.0	5.7	6.3	3.8	4.00
<b>2. Durrës</b>	<b>67,181</b>	<b>31,044</b>	<b>13.5</b>	<b>12.8</b>	<b>6.4</b>	<b>7.8</b>
Durrës	48,562	23,265	14.0	14.4	7.1	8.88
Shijak	2,446	704	3.2	3.0	2.0	0.71
Krujë	16,173	7,075	17.4	12.2	4.5	4.75
<b>3. Dibër</b>	<b>65,572</b>	<b>27,397</b>	<b>37.9</b>	<b>32.7</b>	<b>0.8</b>	<b>0.6</b>
Dibër	37,839	16,840	50.3	47.0	0.4	0.19
Mat	10,340	5,172	28.4	29.0	3.3	2.71
Bulqizë	7,039	3,451	17.5	17.5	0.3	0.36
Klos	10,354	1,933	49.3	18.8	0.1	0.11
<b>4. Elbasan</b>	<b>92,935</b>	<b>46,007</b>	<b>21.7</b>	<b>20.9</b>	<b>2.1</b>	<b>1.9</b>
Elbasan	29,500	13,638	14.3	13.0	4.9	4.88
Cërrik	9,486	4,930	19.4	19.8	0.9	1.00
Belsh	3,637	1,387	10.8	8.1	1.7	0.50
Peqin	16,004	7,636	40.4	37.8	0.0	0.07
Gramsh	11,921	6,162	34.8	37.5	0.2	0.12
Librazhd	9,679	5,947	30.3	36.6	1.5	1.06
Prrenjas	12,708	6,307	37.5	31.2	0.9	0.62
<b>5. Fier</b>	<b>89,125</b>	<b>39,946</b>	<b>22.8</b>	<b>20.7</b>	<b>2.0</b>	<b>2.05</b>
Fier	46,447	19,531	23.0	19.7	1.7	1.77
Patos	2,815	1,389	24.9	24.8	0.6	0.51
Roskovec	2,435	1,872	22.0	20.7	1.0	0.49
Lushnjë	32,272	14,802	24.8	21.9	3.8	4.30
Mallakastër	3,239	1,929	24.1	25.5	0.1	0.27
Divjakë	1,917	423	15.7	15.5	0.6	0.00
<b>6. Gjirokastrë</b>	<b>18,356</b>	<b>8,424</b>	<b>12.5</b>	<b>11.6</b>	<b>3.2</b>	<b>2.3</b>
Gjirokastrë	1,787	597	3.4	2.3	43.0	53.13
Permet	4,308	1,925	21.7	19.4	0.4	0.60
Libohovë	1,358	654	22.9	22.2	0.0	0.00
Kelcyrë	2,678	1,305	23.4	20.3	0.0	0.00

Dropull	2,850	1,595	12.7	14.5	0.0	0.00
Tepelenë	1,603	827	10.2	10.8	3.8	2.69
Memaliaj	3,772	1,521	19.7	16.1	0.0	0.00
<b>7. Korçë</b>	<b>84,130</b>	<b>39,107</b>	<b>24.6</b>	<b>22.9</b>	<b>4.2</b>	<b>3.90</b>
Korçë	30,670	14,135	23.4	21.1	8.4	6.95
Pogradec	34,461	15,757	37.5	35.1	1.2	1.73
Devoll	6,838	3,188	16.7	15.7	1.6	1.43
Pustec	1,142	614	10.3	11.3	29.8	29.33
Kolonjë	1,119	575	21.6	22.7	1.3	1.74
Maliq	9,900	4,837	16.0	15.9	0.7	0.31
<b>8. Kukës</b>	<b>51,300</b>	<b>24,275</b>	<b>46.7</b>	<b>43.4</b>	<b>0.6</b>	<b>0.5</b>
Kukës	25,667	12,031	42.8	39.3	1.1	0.81
Has	14,400	7,032	66.1	63.9	0.0	0.05
Tropojë	11,233	5,212	39.9	36.3	0.2	0.19
<b>9. Lezhë</b>	<b>42,020</b>	<b>17,552</b>	<b>19.0</b>	<b>16.4</b>	<b>2.2</b>	<b>2.40</b>
Lezhë	24,096	11,326	21.2	20.8	2.8	2.74
Kurbini	7,291	4,444	10.0	12.4	3.4	2.57
Mirditë	10,633	1,782	30.5	10.5	0.0	0.00
<b>10. Shkodër</b>	<b>104,774</b>	<b>55,725</b>	<b>31.6</b>	<b>34</b>	<b>7</b>	<b>7.5</b>
Shkodër	51,262	28,362	25.0	28.2	13.0	13.72
Malësi e Madhe	34,461	17,034	63.9	64.5	1.0	0.97
Pukë	6,838	3,188	61.8	58.8	3.5	4.24
Fushë Arrëz	1,142	614	9.8	10.8	0.0	0.00
Vau Dejës	11,071	6,527	22.1	26.6	0.5	0.09
<b>11. Tiranë</b>	<b>47,464</b>	<b>23,704</b>	<b>14.4</b>	<b>12.2</b>	<b>10.3</b>	<b>12</b>
Tiranë	110,768	45,421	12.8	10.5	15.2	17.55
Kamëz	34,461	17,277	23.7	23.7	0.7	0.50
Vorë	6,838	1,054	32.8	10.1	0.4	2.63
Kavajë	1,142	614	1.5	1.6	6.8	5.50
Rrogozhinë	9,900	4,837	43.0	42.0	0.4	0.26
<b>12. Vlorë</b>	<b>15,582</b>	<b>7,978</b>	<b>19.7</b>	<b>20.2</b>	<b>2.5</b>	<b>2.3</b>
Vlorë	5,472	2,635	18.7	19.3	3.8	4.33
Delvinë	1,675	807	30.8	31.2	0.7	1.13
Finiq	821	482	22.5	23.1	0.8	1.04
Himarë	1,783	1,123	29.6	30.0	0.0	0.00
Konispol	1,435	754	24.8	25.2	0.1	0.29
Sarandë	4,396	2,177	23.2	23.8	1.4	1.08
Selenicë						
<b>Gjithsej</b>	<b>725,903</b>	<b>344,862</b>	<b>23.7</b>	<b>22.4</b>	<b>3.6</b>	<b>3.8</b>

Figura 32 paraqit peshën e secilit grup ndaj totalit të individëve në nevojë kritike për shërbime të përkujdesit shoqëror

Figura 32: Grupe në nevojë kritike për shërbime, përqindje




Burimi: Studimi, Maj 2023

Të dhënat e figures 32 reflektojnë përbërjen e individëve në nevojë sipas grupeve në përqindje, ku qartësisht individët në nevojë ekonomike dhe sociale përbëjnë grupin me peshën më të madhe, 31%, i pasuar nga "Të moshuarit" (24%), "Të rritur AK" (18%), "Fëmijë në kushte kritike" (10%), "Pa strehë" (6%), "Gra" (5%), "Fëmijë AK" (4%) dhe "Të rinj në nevojë" (1%).

Në figurën 32, i njëjti informacion paraqitet sipas qarqeve, ku siç konstatohet qarku me peshën më të vogël të individëve në nevojë është Gjirokastra, ndërsa ai me përqindjen më të lartë është Tirana.

Figura 33: Individët në nevojë në çdo qark në % ndaj totalit



Burimi: Studimi, Maj 2023

Nëse krahasojmë të dhënat e figurave 32 dhe 33 me të dhënat e figures 22 dhe tabelës 7 mbi përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror sipas grupeve dhe qarqeve, konstatojmë se pavarësisht përqindjeve të ndryshme, në përgjithësi përputhen, çka do të thotë se edhe metodat e tërthorta mund të përdoren për vlerësimin e situatës së nevojave për shërbime.


I vetmi kufizim i mënyrës së vlerësimit të përdorur këtu është fakti se në vlerësimin e nevojës nuk janë përfshirë individët që kanë nevojë vetëm për shërbime të mbrojtjes dhe të integritit social, si psh fëmijët jashtë kujdesit prindëror, fëmijët e rrugës, fëmijët e dhunuar e të shfrytëzuar, gratë-viktima të dhunës e shfrytëzimit etj, pra në përgjithësi individë të cilët aplikojnë për shërbime në bashki, ndërsa rastet e paraqitura analizohen dhe menaxhohen nga strukturat përkatëse. Kështu, për të patur një vlerësim të plotë e të saktë të nevojës për shërbime është e nevojshme që të nxitet zhvillimi dhe funksionimi i sistemit MIS në të gjitha bashkitë e vendit, shoqëruar me investimin në rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në bashki dhe institucione.

Në vlerësimin e përgjithshëm të nevojës për shërbime duhet të konsiderojmë edhe nevojën e paplotësuar, për të cilën, edhe pse nuk kemi të dhëna të mjaftueshme, përsëri, nëpërmjet treguesve jo të drejtëpërdrejtë dhe të dhënave cilësore, do të mundësojmë formëzimin e gjykimit mbi nevojën e investimit në zhvillimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror të udhëhequr nga identifikimi i nevojës.

Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror përfaqësojnë vetëm 3,4% të përfituesve të ndihmës monetare, gjë e cila kërkon trajtimin me përparësi të nevojës të fuqizimit të shërbimeve ekzistuese si edhe të ndërtimit të shërbimeve të reja.

Së fundmi, vlerësimi cilësor argumenton nevojën e ndërtimit të 384 shërbimeve të tjera (tabela 11 dhe figura 34), nga të cilat rreth 25% duhet të shërbejnë për të moshuarit, 18% për të rritur me AK, etj.

Figura 34: Shpërndarja e shërbimeve të munguara sipas grupeve, në përqindje



Burimi: Studimi, Maj 2023

Figura 34 edhe një here konfirmon renditjen e grupeve në nevojë sipas kriticitetit, për rrjedhojë mund të shërbejë për të orientuar investimet në të ardhmen. Tabela 11 sjell informacion të detajuar mbi shpërndarjen e shërbimeve të munguara në bashkitë e vendit si edhe sipas grupeve. Këto të dhëna të harmonizuara me gjetjet e studimit shërbejnë për të formuluar konkluzionet e përgjithshme të studimit.

Tabela 11: Vlerësimi cilësor i nevojës për shërbime të munguara, sipas grupeve, bashkive dhe qarqeve

Bashkitë sipas qarqeve	Shëbime që mungojnë, sipas grupeve përkatëse/Vlerësim cilësor											Shërbimet gjithsej	
	Individë në Familje në nevojë	Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	Fëmijë AK	Të rinj në konflikt me ligjin	Të rinj me probleme sociale	Të rritur AK	Të pastrehë	Viktima të dhunës	Viktima të trafikimit	Romë	Egjyptianë		Të moshuar
<b>1. Berat</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>8</b>	<b>36</b>
Berat	1	1	3	2		2		3		1		4	17
Kuçovë			1		1	1		2				3	8
Poliçan			1			1							2
